Në qoftë se e ka blé.	Se lo ha comprato.

PARTE SECONDA

ESERCIZI DI CONVERSAZIONE

1

Kush âsht atje?	Chi è là?
Kush trakllon në derë?	Chi bussa alla porta?
Kush ka ardhë?	Chi è venuto?
Nga vjen?	Donde viene?
Çka don?	Che cosa vuole?
Kê kërkon?	Chi cerca?
Pse ka ardhë?	Perchè è venuto?
Çka thotë?	Che cosa dice?
Ku do me shkue?	Dove vuol andare?
Kur ke m'u nisë?	Quando partirai?
A do të rrijsh ndonji ditë?	Ti fermerai qualche giorno?
A do të vonohesh shumë?	Tarderai molto?
Kur ke m'u kthye?	Quando ritornerai?
Çka bân këtu?	Che fai qui?
Kê po pret?	Chi aspetti?
A âsht kush në shtëpi?	Vi è qualcuno in casa?
Ku mund t'a gjêj?	Dove lo posso trovare?
A ka ardhë ndokush me më kërkue?	E' venuto qualcuno a cercarmi?
Ku po shkon?	Dove vai?
Çka do me blé.	Che cosa vuoi comperare?
A m'a bân nji nderë?	Mi vuoi fare un favore?
Ku e ke pá?	Dove l'hai visto?
A e shef shpesh?	Lo vedi spesso?
Ku rri mâ fort?	Dove sta di più?
Si âsht me shëndet?	Come sta di salute?

2

A keni nji pêndë me m'a dhânë?	Ha Lei una penna da darmi?
Pêndë e divit janë mbi tryezë.	Penna e calamaio sono sul tavolo.
Diviti tek âsht, por pêndën s'po e gjêj.	Il calamaio c'è, ma la penna non la trovo.

Kush do t' a ketë marrë?	Chi l'avrà presa?
Do t a keni harrue më ndonji vênd.	L'avrà dimenticata in qualche posto.
A doni me shkrue me lapës?	Vuol scrivere con la matita?
M' epni nji lapës të zezë.	Mi dia una matita nera.
A keni edhe pak letër?	Ha anche un po' di carta?
Kqyrni në raft; aty janë disa tabakë letër e zarfa.	Guardi nell'armadio; lì vi sono alcuni fogli di carta e buste.
Kuj po i shkruen?	A chi scrivi?
Po i shkruej vllaut.	Scrivo al fratello.
Ku gjindet tash?	Dove si trova ora?
Ka shkue në Milan.	E' andato a Milano.
A do të kthejë shpejt?	Ritornerà presto?
E presim javën qi vjen.	L'aspettiamo la settimana prossima.
A e keni sherbtorin këtu?	Ha il servo qui?
Në shtëpí do të jetë.	Deve essere in casa.
Për çka ju duhet?	Perchè le occorre?
Po më duhet me e çue në nji vênd.	Mi occorre per mandarlo in un posto.
A t' a thërras tash?	Vuole che lo chiami ora?
M' a thirrni!	Me lo chiami.

3

A e njifni këtˆ zotní?	Conosce questo signore?
Po, e njof.	Sì, lo conosco.
Kush âsht?	Chi è?
Âsht nji i huej.	E' uno straniero.
Çfarë kombsije âsht? A âsht Ingliz a Gjerman?	Di che nazionalità è? E' Inglese o Tedesco?
Nuk âsht as Ingliz as Gjerman; âsht Italjan.	Non è nè Inglese nè Tedesco; è Italiano.
A e flet frêngiishten?	Parla il francese?

Po, zotni, frêngjishten e flet shumë mirë; ka nxânë pak edhe shqip.
A di me folë gjermanisht?
Nuk e besoj.
Çfarë gjuhe flet me tê?
Flas italisht.
A e kuptoni italishten?
Italishten e kuptoj mirë.
Çë punë bân?
Merret me tregti; âsht përfaqsuesi i nji shtëpije tregtare.
A ka bâ punë në treg t'onë?

Ka marrë disa porosina.
Sonde niset.
Ku shkon?
Kthen në vênd të vet.

Si, signore, il francese lo parla assai bene; ha imparato un po' anche l'albanese.
Sa parlare tedesco?
Non lo credo.
Che lingua parli con lui?
Parlo in italiano.
Comprende l'italiano?
L'italiano lo comprendo bene.
Che mestiere fa?
Esercita il commercio; è il rappresentante di una casa commerciale.
Ha fatto affari nel nostro mercato?
Ha ricevuto alcune ordinazioni.
Stasera parte.
Dove va?
Ritorna al suo paese.

4

A e ke pá kushrînin t'ând?
Jo, sot nuk e kam pá.
A e ke pá dje?
Dje e kam pá.
Ku mund t'a gjêj?
Ndoshta në shtëpí. Në mos qoftë në shtëpí atëherë do të ketë shkue në fshat.
Ku e ka shtëpín? Ku banon?
Në këtë rrugë në të djathtë.
Çë punë keni me tê?
Kam blé prej tij do grunë.
Me çfarë mjeti keni me e bajtë?

Hai visto tuo cugino?
No, oggi non l'ho visto.
L'hai visto ieri?
Ieri l'ho visto.
Dove posso trovarlo?
Forse a casa. Se non c'è a casa, allora sarà andato al villaggio.
Dove ha la casa? Dove abita?
In questa via, a destra.
Che affari ha con lui?
Ho comprato da lui del grano.
Con quale mezzo lo trasporterà?

Do t' a çoj me barkë.
A e keni ngarkue mallin?
Nuk e kam ngarkue ende; barka âsht tue shkarkue do lândë qi ka prû prej Trieshtet.
A âsht larg fshati prej këndej?
Nuk âsht larg fort; për dý orë mund të shkohet.
Sonde ka me kthye në shtëpi; nuk flén në katund.

Lo manderò col veliero.
Ha caricato la merce?
Non l'ho caricata ancora; il veliero sta scaricando del legname che ha portato da Trieste.
È lontano il villaggio da qui?

Non è molto distante; in due ore ci si può andare.
Stasera ritornerà a casa; non dorme nel villaggio.

5

Mirë se ju gjêj!
Mirë se vijni!
Si jeni me shëndet? A jeni shëndosh e mirë?
Mirë prej Zotit.
Uluni e rrini; pushoni pak.
Urdhnoni e ndizeni nji cingare.
T'u rritë ndera, nuk e pij duhanin Due nji gotë ujë të ftohtë; më ka marrë etja.
A po e pini nji kafe?
Nji kafe po e pij.
Për të mirë.
Të bâftë mirë.
A keni hângër?
Nuk kam hângër edhe; qyshë në mëngjes nuk kam shtie gjâ në gojë.
A ju ka marrë ûja (unija)?

Ben trovato!
Ben venuto!
Come sta di salute? Sta sano e bene?
Bene, per grazia di Dio.
Si sieda; riposi un po'.
Favorisca accendere una sigaretta.
Grazie, non fumo. Voglio un bicchiere d'acqua fresca; ho sete.

Beve un caffè?
Un caffè lo beverò.
Alla sua felicità.
Buon prò le faccia.
Ha mangiato?
Non ho mangiato ancora; da stamattina non ho messo nulla in bocca.
Ha fame?

Nuk po kam û (uni); më ka tretë ânda krejt.
Non ho fame; ho perduto completamente l'appetito.

Sot do të rrini te na për drekë.
Oggi rimarrà a pranzo con noi.

Urdhnoni; sofra âsht gati.
S'accomodi, la tavola è pronta.

6

A dini ku e kam umbrelën?
Sa dov'è il mio ombrello?

Nuk e dij.
Non lo so.

A e di sherbtori se ku e kam vû?
Sa il cameriere dove l'ho messo?

As sherbtori nuk e di.
Neanche il cameriere lo sa.

A e keni pyetë.
Gliel'ha domandato?

Po, e kam pyetë.
Sì, gliel'ho domandato.

Ndoshta do t'a dijë sherbtorja.
Forse lo saprà la cameriera.

Sherbtorja mund t'a dijë pse ajo e ka ndreqë odën.
La cameriera può saperlo perchè essa ha accomodata la stanza.

A m'a thërritni?
Me la vuol chiamare?

Çka urdhnoni zotni?
Che cosa comanda, signore?

A e keni pá umbrelën t'eme?
Ha visto il mio ombrello?

Po, ju a kam vû në raft.
Sì, gliel'ho messo nell'armadio.

Në cilin raft?
In quale armadio?

Në raftin e madh.
Nel grande armadio.

Aty s'kam kqyrë.
Lì non ho guardato.

Ku âsht çelsi? Ku e keni vû?
Dov'è la chiave? Dove l'ha messo?

E kam vjerrë në gozhdë.
L'ho appesa al chiodo.

Në gozhdë nuk po e shof.
Al chiodo non la vedo.

Do të ketë rá poshtë.
Sarà cascata giù.

Qe tek âsht,
Eccola.

M a merrni, ju lutem.
La prego, me la prenda.

7

A ka ardhë lasja e petkavet?
Po, ka ardhë sot në mëngjes.
A i ka marrë petkat për me i lá?
I a kam dhânë të gjitha edhe i a kam numrue.
A e keni mbajtë listën?
Listën e kam unë.
Qe petkat qi ka marrë: dy çarçafa, dý faqe jastekësh, gjashtë këmisha, katër parë brekë, dý fanela të leshta, tetë parë çarapë, pesë qafza e dhetë shamija.
A e ke porosit me i lá mirë? Herën tjetër nuk i ka lá mirë.
Ksaj here e kam porositë mjaft; i kam thânë edhe me i hekurosë
Kur ka me i prû?
Të shtunën mbrâma.

E venuta la lavandaia?
Sì, è venuta stamattina.
Ha preso la biancheria da lavare?
Gliel' ho data tutta e gliel'ho contata.
Ha tenuta la nota?
La nota l'ho io.
Ecco la biancheria che ha preso: due lenzuola, due federe, sei camicie, qnattro paia di mutande, due maglie di lana, otto paia di calze, cinque colletti e dieci fazzoletti.
Le ha raccomandato di lavarla bene? L'altra volta non l'ha lavata bene.
Questa volta l'ho avvertita abbastanza; le ho detto pure di stirarla.
Quando la riporterà?
Sabato sera.

8

A po më rrueni?
Urdhnoni, zotni.
Due edhe m' u qethë.
A doni me i shkurtue flokët shumë a pak?
Ashtu, ashtu; por kqyrni me më qethë mirë.
Mos kini dyshim.

Vuole farmi la barba?
S'accomodi, signore.
Voglio tagliare anche i capelli.
Li vuole molto corti i capelli oppure un po'?
Così, così; ma guardi di tagliarme i bene.
Non dubiti.

Shikonju në pasqyrë; a doni me jua pré mâ?
Si guardi nello specchio; Li vuole ancora più corti?

Jo mâ tepër; kështu janë mirë.
Non di più; così stanno bene.

Ju dalshin me shëndet.
Con la salute!

Shëndet paçi.
Abbia salute. (Grazie).

Në dyqan po shof gjithfarë sapunash me erna; a i shitni?
Nel negozio vedo ogni sorta di saponi profumati; si vendono?

Po, kemi edhe erna të mira, pasta për dhâmbë, brusha (vurca) dhâmbësh, krâhna, brisq rrues.
Sì, abbiamo anche profumerie, paste dentifricie, spazzolini per denti, pettini e rasoi.

Sa kushton kjo shishe me ujë Kolonjet?
Quanto costa questo flacone di acqua di Colonia?

A janë të mirë këta sapuna?
Sono buoni questi saponi?

Janë të mirë edhe të lirë.
Sono buoni ed a buon prezzo.

Më jepni edhe ni brushë dhâmbësh e nji pastë për dhâmbë.
Mi dia anche uno spazzolino per denti ed una pasta dentifricia.

Sa bâjnë gjithsejt?
Quanto fanno in tutto?

9

Çë ditë âsht sot?
Che giorno è oggi?

Sot âsht e marte, dje ka qênë e hânë, nesër âsht e mërkurë.
Oggi è martedì; ieri è stato lunedì; domani è mercoledì.

Kur âsht ditë tregu?
Quando è giorno di mercato?

T' êjten âsht ditë tregu.
Giovedì è giorno di mercato.

Në ç' muej jemi?
In che mese siamo?

Tash jemi në qershuer; mueji qi shkoi qe mueji i majit; mueji qi vjen ka me qênë korriku.
Ora siamo in giugno; il mese scorso fu il mese di maggio; il mese venturo sarà luglio.

Kur mbaron kambjali?
Quando scade la cambiale?

Kambiali mbaron në shtatuer.	La cambiale scade in settembre.
Sa kemi sot?	Quanti ne abbiamo oggi?
Sot jemi në njizet e nândë.	Oggi ne abbiamo ventinove.
Nesër mbaron muej.	Domani finisce il mese.
Në cilën stinë jemi?	In quale stagione siamo?
Na jemi në prendverë; edhe dý javë fillon vera.	Noi siamo in primavera; ancora due settimane e comincia l'estate.
Sa vjeç jeni?	Quanti anni ha lei?
Jam njizet e pesë vjeç.	Ho venticinque anni.
Kur keni lé?	Quando è nato?
Kam lé në vjetin njimijë e nândë qind e katër.	Sono nato nell'anno mille novecento e quattro.
Çë moshet e keni djalin?	Che età ha il Suo bambino?
Në prill mbush tri vjet.	In aprile compie tre anni.
Tash sa vjet jeni martue?	Da quanti anni lei si è sposato?
Jam martue tash pesë vjet.	Mi sono sposato da cinque anni.

10

Sa âsht sahati?	Che ora è?
Âsht njimbëdhetë e dhetë dekika; nuk âsht edhe mjesditë.	Sono le undici e dieci minuti; non è ancora mezzogiorno.
Qetash ra njimbëdhetë.	Ora sono suonate le undici.
Sahati i em nuk punon mirë; shkon pak përpara.	Il mio orologio non funziona bene; va un po' avanti.
A doni qi të ju a ndreqi?	Vuole che glielo aggiusti?
Tash âsht mirë; nuk âsht as përpara, as mbrapa.	Adesso va bene, non va nè avanti, nè indietro.
Në ç'orë bini me fjetë?	A che ora va a letto?
Kah mjesnata.	Verso mezzanotte.
A çoheni heret në mëngjes?	Si alza presto la mattina?

Në gjashtë.	Alle sei.
Kur jeni çue sot?	Quando si è levato oggi?
Jam çue pak vonë.	Mi sono levato un po' tardi.
Nuk kam bâ gjumë të mirë.	Non ho dormito bene.
Në ç' orë delni në mëngjes?	A che ora esce la mattina?
Dal heret.	Esco di buon'ora.
Kur mundem me ardhë?	Quando posso venire?
Deri në tetë më giêni në shtëpí.	Fino alle otto mi trova a casa.
Ku mund të piqemi mbrâma?	Dove possiamo incontrarci stasera?
Në lulishtë popullore.	Al giardino pubblico.

11

Ju lutem, zotní, si i thonë ksaj rruge?	La prego, signore, come si chiama questa via?
Kjo âsht rruga	Questa è la via . . . . .
Ku âsht zyra e policís?	Dov'è l'ufficio di polizia?
Zyra e policís nuk âsht në këtë rruge.	L'ufficio di polizia non è in questa via.
Në ç' rrugë gjindet?	In che via si trova?
Shkoni drejt deri te kazerma, pastaj merrni rrugën qi gjêni kah e djathta, e aty mbas trí a katër shtëpive âsht zyra e policís.	Vada diritto fino alla caserma, poi prenda la via che incontrerà a destra, e lì dopo tre o quattro case c'è l'ufficio di polizia.
A keni mirsín me më diftue edhe zyrën e bankës kombtare?	Ha la bontà d'indicarmi anche l'ufficio della banca nazionale?
Zyra e bankës kombtare âsht në rrugën . . . . numri	L'ufficio della banca nazionale è in via . . . . . numero . . . .
Zotní komiser! Kam ardhë me marrë pasapotën t eme.	Signor commissario! Son venuto a ritirare il mio passaporto.

Si ju thonë emnit?
Më falni, zotní; më diftoni emnin, mbiemnin dhe nga jeni.
Kur keni ardhë?
Kam ardhë tash nji javë.
Kur do të niseni?
Kam me u-nisë nesër.
Kjo pasaportë ka mbarue; duhet të bâni nji pasaportë të ré.
Kur mund të vij me e marrë?

Pasdreke do të jetë gati.

Come si chiama?
Scusi, signore; mi dica il nome, il cognome e di dove è.

Quando è venuto?
Sono qui da una settimana.
Quando partirà?
Partirò domani.
Questo passaporto è scaduto; occorre fare un nuovo passaporto.
Quando posso venire a prenderlo?
Dopo pranzo sarà pronto.

Në doganë.

Hamall, merrni valigjet e mija. Ku âsht dogana?
Dogana âsht këtu afër, zotní.

A dishroni nji hotel të mirë?
Jo, nuk do të ndalem në Durrës, do të nisem sot për Tiranë.
Qe dogana.
Zotní a po urdhnoni me m'i shikue (kontrollue) plaçkat e mija?
Ku janë?
Këto janë teshat e mija.
A keni ndonji send qi paguen doganë?

Alla dogana.

Facchino, prendete le mie valigie. Dov'è la dogana?
La dogana è qui vicino, signore.
Desiderate un buon albergo?
No, non mi fermerò a Durazzo, partirò oggi stesso per Tirana.
Ecco la dogana.
Signore, volete favorire di controllarmi le valigie?

Dove sono?
Questi sono i miei bagagli.
Avete qualche cosa soggetta a dazio doganale?

Kam vetëm teshat qi veshi; nuk kam kurrgiâ qi paguen doganë.
A keni të tjera plaçka?
Jo, vetëm këto qi po shifni.

Këto petka duken të reja, por janë të përdorueme.
Çka keni n' at kuti?

Kam disa sende qi më duhen për udhë: brisk rrues, gërshânë, krâhën, brushë petkash.
Urdhnoni, zotni, jeni të lirë.
Hamall, më gjêni nji automobil për Tiranë.
Po shkojmë n' agjenci t automobilave.
A âsht shum larg agjencija?
Jo, zyra e agjencís âsht këtu afër.
A mund të gjindet tash ndonji automobil gati?
Automobila për Tiranë ka orë e ças.
A âsht larg Tirana?
Âsht larg 37 km. prej Durrsit.
Udha âsht e mirë.
A ndalet më ndonji vênd?
Kalon nëpër Shjak, por nuk ndalet.
A âsht qytet i madh Shjaku?

Ho soltanto effetti personali; non ho nessuna cosa soggetta a dazio doganale.
Avete altri bagagli?
No, solamente questi che vedete.
Questi abiti sembrano nuovi, ma sono usati.
Che cosa avete in quella scatola?
Ho certe cose occorrenti per il viaggio: rasoio, forbici, pettine, spazzola da abiti.

Favorite, signore, siete libero.
Facchino, trovatemi un automobile per Tirana.
Andiamo all'agenzia delle automobili.
È molto distante l'agenzia?
No, l'ufficio dell'agenzia è qui vicino.
Si può trovare adesso qualche automobile pronta?
Automobili per Tirana ce ne sono in ogni momento.
È distante Tirana?
Dista 37 km. da Durazzo.

La strada è buona.
Si ferma in qualche posto?
Passa per Shjak, ma non si ferma.
È una grande città Shjak?

Shjaku âsht nji qytet i vegël, por i pasun me prodhime bujqsije e me bakti
Tash mbërrijtëm n' agjenci.
Kjo âsht zyra.
Qe të hollat.
Ju falem nderës e ju qoftë udha e mbarë.

Shjak è una piccola città, ma ricca di prodotti agricoli e di bestiame.
Ora siamo arrivati all'agenzia.
Questo è l'ufficio.
Ecco i soldi.
Grazie e buon viaggio,

Durrsi.

Ku doni me shkue, zotni?
Në Tiranë.
Sa vetë jeni?
Unë vetëm.
A keni shumë plaçka?
Kam vetëm dý valigie. Automobili niset mbas nji oren.
Urdhnoni e rrini. Nga vijni?
Vij prej Barit.
A keni qênë ndonji herë tjetër në Shqipni?
Ky âsht i pari udhtim qi po bâj në Shqipni.
A keni bâ ndonji sheti nëpër qytet?
Jo, kam pá vetëm limanin, nji lulishte popullore në breg të detit dhe disa ndërtesa e dyqane te reja.
Si ju âsht dukë limani.
Limani qénka mjaft i hapët e paska nji tregti të gjallë.

Durazzo.

Dove vuole andare, signore?
A Tirana.
In quanti siete?
Io solo.
Avete molti bagagli?
Ho soltanto due valigie L'automobile parte fra un'ora.
Sedete. Donde venite?
Vengo da Bari.
Siete stati qualche altra volta in Albania?
Questo è il primo viaggio che faccio in Albania.
Avete fatto qualche passeggiata per la città?
No, ho visto solamente il porto, un giardino pubblico alla spiaggia ed alcuni edifizi e negozi nuovi.
Come vi è sembrato il porto?
Il porto è abbastanza ampio ed ha un commercio attivo.

Durrsi âsht i pari liman tregtar i Shqipnís. Ka qênë gjithmonë nji sqele deti me rândsí.

Por qyteti më duket i vogël.

Qyteti nuk ka mâ tepër se 9.000 banorë.

E me cilat vênde e bân gjithë këtë t egtí?

Me liman të Durrsit punojnë të gjitha vêndet e Shqipnís së mesme: Tirana, Kavaja, Kruja, Shjaku, Elbasani e deri Berati e Korça.

E çfarë gjânash eksporton?

Tregtín e bân me Italí, me Greqí, e me Jugoslaví. Eksporton lesh, lëkura, misër, tërshânë, voj, bakti, pula, vé.

Kam pá edhe disa mure të moçme.

Ato janë muret e kalás së vjetër, ndërtue prej Venedikasvet.

A âsht shum' i moçëm qyteti?

Durrsi âsht nji qytet shum' i vjetër. Motit quhej Epidamnus e Dyrrhachium.

Në vjetin 250 p. K. ka qênë kolonì rromake. Në Durrës vijshin shum Rroma-

Durazzo è il primo porto commerciale dell' Albania. E' stato sempre uno scalo marittimo d'importanza.

Ma la città mi sembra piccola.

La città non ha più di 9.000 abitanti.

E con quali paesi fa tutto questo traffico?

Col porto di Durazzo lavorano tutti i paesi dell' Albania centrale: Tirana, Cavaja, Croja, Shjaku, Elbasan e perfino Berat e Korcia.

Che articoli esporta?

Il commercio lo fa con l'Italia, con la Grecia e con la Jugoslavia. Esporta lana, pelli, granone, avena, olio, bestiame, pollami, uova.

Ho visto anche delle vecchie mura.

Sono le mura del vecchio castello, costruito dai Veneziani.

E' molto antica la città?

Durazzo è una città molto vecchia. Anticamente chiamavasi Epidamnus e Dyrrachium.

Nell' anno 250 av. Cr. è stato colonia romana. A Durazzo venivano molti nobili Romani

kë fisnikë me verue. Për do kohë ka banue edhe Ciceroni.

A janë gjetë vjetërsina në këtë qytet?

Nën muret e kalás së vjetër janë gietë shtatore, enë e sarkofagë shumë të bukur, të cilët mund të shifen në muzé të Tiranës.

Shtëpit nuk duken shumë të moçme.

Durrsi âsht rrenue shumë herë prej tërmekut (në vjetin 348-525-1273-1926).

Mbi rrenime âsht ndërtue prap.

A ka afër ndonji tjetër vênd historik?

Nji orë larg qytetit gjinden shêjet e nji muri të gjatë i cili qe ndërtue prej Rromakvet për mprojtje të qytetit. Ai vênd quhet edhe sot **Porto Romano.**

Në Durrës kanë sundue edhe Venedikasit.

Venedikasit e kanë mbajtë Durrsin prej vjetit 1392 e deri me 1501. Në vjetin 1502 ka rá nën sundim të Tyrqvet.

Mbi kodër kam pá nji ndërtesë të madhe.

a passare l'estate. Per un po' di tempo vi ha dimorato anche Cicerone.

Si sono trovate delle antichità in questo paese?

Sotto le mura del vecchio castello si sono trovate statue, vasi e magnifici sarcofaghi i quali si possono vedere nel museo di Tirana.

Le case non sembrano molto antiche.

Durazzo è stato distrutto molte volte dal terremoto (nell'anno 348-525-1273-1926).

Sulle rovine è stato costruito di nuovo.

Ha vicino qualche altro luogo storico?

Un'ora lontano dalla città si trovano le tracce di un lungo muro il quale fu costruito dai Romani per la difesa della città. Quel luogo si chiama anche oggidì Porto Romano.

A Durazzo hanno governato anche i Veneziani.

I Veneziani hanno tenuto Durazzo dall'anno 1392 fino al 1501. Nell'anno 1502 è caduto sotto il dominio dei Turchi.

Sulla collina ho visto un grande edifizio.

Sipër kodërs âsht vila e Mbretit, nji ndërtesë shum' e bukur.

Sulla collina è la villa Reale, un magnifico edifizio.

A keni nji gotë ujë të ftohtë?

Avete un bicchiere d'acqua fresca?

Po, zotni, por nuk âsht i ftohtë. Uji na mungon e nuk âsht as i mirë.

Sì, signore, ma non è fresca. L'acqua ci manca e non è neanche buona.

Si âsht klima e Durrsit?

Com'è il clima di Durazzo?

Klima âsht e butë, por nuk âsht e shëndostë Vëndi ka moçale e prandej âsht malarik

Il clima è mite, ma non è sano. Il paese ha paludi e perciò è malarico.

Urdhnoni, zotni, automobili âsht gati.

Favorite, signore, l'automobile è pronta.

Lâmtumirë.

Addio.

Udha e mbarë.

Buon viaggio.

Në hotel.

A keni ndonji odë lirë me nji shtrat?

Po, e kemi nji në katin e parë.

Urdhnoni me e pá.

Qênka fort e vogël e nuk paska mjaft dritë. A keni ndonji odë mâ të mirë?

Nesër lirohet nji odë mâ e madhe me dritore qi kqyrin kah rruga.

Mirë. Atëherë për sonde m'a ndreqni shtratin në këtë odë.

Tash po ju bije valigjet nalt.

All'albergo.

Avete una stanza libera con un letto?

Sì, ne abbiamo una al primo piano.

Favorite a vederla.

E' molto piccola e non ha abbastanza luce. Avete qualche stanza migliore?

Domani sarà libera una stanza più grande con finestre che guardano sulla strada.

Va bene. Allora per stasera accomodatemi il letto in questa stanza.

Adesso vi porto su le valigie.

A dishroni ndonji send tjetër?

Desiderate qualche altra cosa?

Hoteli a ka odë banje?

L'albergo ha stanza da bagno?

Nuk ka odë banje.

Non ha stanza da bagno.

Më bini pak ujë për m' u lá, sapun e nji peshqir të pastër.

Portatemi un po' d'acqua per lavarmi, sapone e un asciugamano pulito.

A âsht i mirë ujët qi pihet?

E' buona l'acqua potabile?

Âsht ujë kroi, por jo i ftohtë?

E' acqua di fontana, ma non è fresca.

A dishroni ujë mineral?

Desiderate dell'acqua minerale?

Jo, më bini nji shishe me ujë kroi e nji kafe.

No, portatemi una bottiglia d'acqua comune (di fontana) ed un caffè.

A ka këtu afër restorant?

Vi è qui vicino qualche ristorante?

Në daçi mund të hani edhe këtu. Hoteli ka poshtë restorantin.

Se volete, potete mangiare anche qui. L'albergo ha di sotto il ristorante.

Shumë mirë. Nesër due të më zgjoni heret.

Benissimo. Domani voglio che mi svegliate di buon'ora.

Në ç orë dishroni m' u çue?

A che ora desiderate di essere svegliato?

Në 7; në 7 1/2 më bini nji kafe me qumësht e pak bukë të freskët.

Alle 7; alle 7 1/2 portatemi un caffè latte e un po' di pane fresco.

Në ardhët me më kërkue ndokush thoni se jam zânë.

Se verrà qualcuno a cercarmi ditegli che sono occupato.

Pres nesër në mëngies prej orës 10 deri në 12.

Ricevo domani mattina dalle ore 10 alle 12.

A urdhnoni tjetër gjâ?

Desiderate qualche altra cosa?

Jo, së due mâ kurrgiâ.

No, non voglio più niente.

Po të keni nevojë për ndonji send mund t' i bini zyles.

Se vi occorrerà qualche cosa potete suonare il campanello.

Në restorant.

A keni ndonji send gati për me hângër?
Çka t'urdhnoni: lâng mishi, supë, makarona me salcë, pulë të zieme, mish me kunguj, mish të kuqun me kërtola, mish të pjekun, peshk të fërguem.
Qe lista e gjellvet.
Çfarë supe keni?
Ka supë me pastinë e çorbë me barishte.
Më bini nji çorbë me barishte.
Çfaret âsht mishi i kuqun?
Mishi i kuqun âsht viçi, mishi me kunguj âsht dashi e ai i furrës âsht mish qingji.
Më bini nji mish qingji me sallatë.
Vojin e uthullën.
A dishroni venë, zotni?
Ç' venë keni?
Kemi venë të kuqe, venë të bardhë e venë të vjetër ndër shishe.
Më bini nji shishe venë të kuqe.
A urdhnoni tjetër gjâ?
Trû të fërguem, ngjala, qefull në furrë.
A âsht i mirë djathi?

Al ristorante.

Avete qualche cosa pronto da mangiare?
Quello che desiderate: brodo, minestra, pasta asciutta al pomodoro, pollo allesso, carne con zucchine, arrosto con patate, carne al forno, pesce fritto.
Ecco la lista delle pietanze.
Che minestra avete?
C'è minestra di pastina e minestrone di verdura.
Portatemi un minestrone di verdura.
Di che carne è l'arrosto?
L'arrosto è di vitello, la carne con zucchette è di montone e quella al forno è carne d'agnello.
Portatemi una porzione di carne d'agnello con insalata.
L'olio e l'aceto.
Desiderate del vino, signore?
Che vino avete?
Abbiamo vino rosso, vino bianco e vino vecchio in bottiglie.
Portatemi una bottiglia di vino rosso.
Comandate altro?
Cervello fritto, anguille, cefalo al forno.
E' buono il formaggio?

Djathi âsht shum' i mirë.	Il formaggio è buonissimo.
Dý vé të fërgueme e pak djathë.	Due uova al burro e un po' di formaggio.
Ka edhe âmbëlsina.	Ci sono anche dolci.
Më jepni do pemë: ndonji pjeshkë a dardhë e pak rrush.	Datemi delle frutta: qualche pesca o pera e un po' d'uva.
Më bini nji çinì të pastër.	Portatemi un piatto pulito.
Ju lutem nji kafe.	Vi prego un caffè.
Më bâni hesapin.	Fatemi il conto.
Gati, zotní.	Pronto, signore.
Çka tepron âsht për jue.	Ciò che avanza è per voi.
Ju falem nderës.	Grazie.

Në kafe.	**Al caffè.**
Çka urdhnoni?	Che cosa comandate?
Unë due nji kafe.	Io voglio un caffè.
Ka edhe kafe me qumësht e çaj.	C'è anche caffè latte e thè.
Atëherë më bini nji kafe me qumësht e do âmbëlsina.	Allora portatemi un caffè latte con delle paste.
Ju, çka po merrni?	Voi che cosa prendete?
Nuk po due kurrgiâ, tash e piva nji çaj.	Non voglio niente, adesso ho preso un thè.
Merrni ndonji send tjetër.	Prendete qualche altra cosa.
A doni nji akullore?	Volete un gelato?
Ju falem nderës, po marr nji limonatë.	Grazie, prendo una limonata?
A keni cingare?	Avete delle sigarette?
Gjithë farësh.	Di tutte le qualità.
Më jepni nji kuti cingare të forta	Datemi una scatola di sigarette forti.
Sa bâjnë gjithsejt?	Quanto fanno in tutto?

A çohemi?	Alziamoci?
Më duhet me shkue në postë.	Debbo andare alla posta.
A doni qi të ju përcjelli?	Volete che vi accompagni?
Ju falem nderës, mos u mundoni.	Grazie, non v' incomodate.
Ku do të shifemi pasdıeke?	Dove ci vedremo dopo pranzo?
Po ju pres në hotel.	Vi aspetto all' albergo.
Kam me ardhë me ju marrë në katër.	Verrò a prendervi alle quattro.
Lâmtumirë.	Addio.

Në postë.

A ka letra për mue?
Si Ju quejnë?
Quhem . . . . .
Po, janë dý letra m' emën t' uej; nji letër e porositun e nji e thjeshtë.
Kur ka ardhë posta?
Mbrâmë vonë.
Sa herë në javë shkon për Itali?
Për Itali shkon katër herë në javë.
E për qytete të Shqipnís?
Për disa qytete të Shqipnís, si për Shkodër e për Durrës, niset për ditë.
A ka nesër postë për Itali?
Nesër shkon për Itali edhe vjen.
Në ç' orë mbërrîn?
Mbërrîn në mëngies e niset pasdreke.

Alla posta.

Vi sono lettere per me?
Come si chiama?
Mi chiamo . . . . .
Sì, vi sono due lettere al Suo nome; una lettera raccomandata ed una semplice.
Quando è arrivata la posta?
Ieri sera tardi.
Quante volte alla settimana parte per l' Italia?
Per l' Italia parte quattro volte alla settimana.
E per le città dell' Albania?
Per alcune città dell' Albania, come per Scutari e per Durazzo, parte ogni giorno.
C' è domani posta per l' Italia?
Domani parte per l' Italia ed anche arriva.
A che ora arriva?
Arriva la mattina e parte la sera.

Në ç' orë mbyllet pasdreke zyra e postës?

Zyra e postës mbyllet në 6, por pranohen letra të posituna e të thjeshta edhe nesër në mëngjes.

Sa âsht tarifa e letravet të thjeshta për Shqipní.

Tarifa e letravet të thjeshta për Shqipní edhe për Italí âsht 15 qindarë ar; për vêndet e tjera 25 qindarë.

Ku blehen pullat?

Këtu.

Më jepni katër pulla nga 10 qindarë, gjashtë pulla nga 5 qindarë dhe trí karta postare.

Ku âsht zyra e tetegrafës?

Âsht në katin e porë.

Ju lutem më jepni letër, pêndë e divit për të shkrue nji telegramë.

Qe, zotní, nji modul për të shkrue telegramën; pênda e diviti janë mbi tryezë.

Sa bân kjo telegramë?

Urdhno e merr diftesën.

Në m'ardhët ndonji telegramë m' a bini në hotel...

Ky âsht drejtimi i em.

A che ora si chiude dopo pranzo l'ufficio postale?

L'ufficio postale si chiude alle 6, ma si ricevono lettere raccomandate e semplici anche domani mattina.

Qual'è la tariffa delle semplici per l'Albania?

La tariffa delle lettere semplici per l'Albania e per l'Italia è 15 centesimi oro; per gli altri paesi 25 centesimi.

Dove si comprano i francobolli?

Qui.

Datemi quattro francobolli da 10 centesimi, sei francobolli da cinque centesimi e tre cartoline postali.

Dov'è l'ufficio telegrafico?

Al primo piano.

Vi prego di darmi carta, penna e calamaio per scrivere un telegramma.

Ecco, signore, un modulo per scrivere il telegramma; la penna ed il calamaio sono sul tavolo.

Quanto costa questo telegramma?

Favorisca prendere la ricevuta.

Se arriverà qualche telegramma portatemelo all'albergo...

Questo è il mio indirizzo.

Tirana.

Ç kohë e bukur! A dishroni me bâ nji shetí nëpër qytet?
Me gjithë qef.
Këtu nuk po shof karroca.
Rrallë shifen karroca; janë shumë automobila.
Tirana paska nji panoramë shumë të bukur.
Âsht përnjimênd vênd piktoresk. Kqyr ç' varg kodrash të bëkura ka për qark Janë kodra t' ulta e të blerta dimën e verë. Kah lindja âsht mali i Dajtit.
A âsht i lartë ky mal?
Maja mâ e larta âsht 1540 m.
Klima e Tiranës do të jetë e butë.
Në dimën nuk bân shumë të ftohtë, por në verë bân të nxetë. Ujët nuk âsht i mirë.
A shkojmë kah tregu?
Si të doni.
Sot âsht e êjte, âsht ditë tregu.
Vijnë katundarë e katundare prej rretheve për të bâ treg.
Qênkan ndërtue rruga të reja e të giâna dhe shumë shtëpija.

Tirana.

Che bel tempo! Desidera fare una passeggiata in città?
Volentieri.
Qui non vedo carrozze.
Di rado si vedono carrozze; ci sono molte automobili.
Tirana ha un panorama magnifico.
E' veramente un paese pittoresco. Guardi che catena di belle colline ha intorno. Sono basse colline e verdeggianti d'inverno e d'estate. Verso levante è il monte Dajti.
È alto questo monte?
La vetta più alta è 1540 m.
Il clima di Tirana sarà mite.

Nell'inverno non fa molto freddo, ma nell'estate fa caldo. L'acqua non è buona.

Andiamo verso il mercato?
Come vuole.
Oggi è giovedì, è giorno di mercato.
Vengono contadini e contadine dai dintorni per il traffico.
Si sono costruite strade nuove e larghe e molte case.

Po, në këto vjetët e mbrapme Tirana ka nisë m' u bâ nji qytet modern. Ka kafe e hotele të mira, dyqane të bukura, lulishte popullore, biblijotekë e nji muzé komb'ar.

A ka shumë banorë?

Populisija âsht tue u-shtue për ditë. Tash ka 30.900 banore.

Sa të bukura këto pëlhura!

Këto pëlhura punohen në vênd. Grát e Tiranës i punojnë shumë mirë pëlhurat e mëndafshit e të lînit si edhe qylymat.

Në treg ardhka gjith'e mira.

Katundarët bijnë me shitë gjithshka: grunë, misër, lesh, lëkura, baktí, voj, pula, vé.

Tirana ka nji fushë pjellore e shumë baktí.

Po ndihet nji zhurmë motori.

Âsht ajroplani qi po vjen prej Korçe. Bije postën edhe udhtarë.

A bân udhtime për qytetet e tjera?

Shkon në Shkodër, në Vlonë, në Gjinokastër, në Korçë.

Udhtimin për Korçë do t'a bâj me ajroplan.

Sì, in questi ultimi anni Tirana ha cominciato a diventare una città moderna. Ha caffè ed alberghi discreti, bei negozi, giardini pubblici, biblioteche ed un museo nazionale.

Ha molti abitanti?

La popolazione sta aumentando ogni giorno. Ora ha 30.900 abitanti.

Come sono belli questi tessuti!

Questi tessuti si lavorano nel paese. Le donne di Tirana lavorano assai bene i tessuti di seta e di lino come pure i tappeti.

Al mercato viene ogni grazia di Dio.

I contadini portano a vendere ogni cosa: grano, granoturco, lana, pelli, bestiame, olio, galline, uova.

Tirana ha una pianura fertile e molto bestiame.

Si sente un rumore di motore.

E' l'aeroplano cha viene da Korcia. Porta la posta e passeggeri.

Fa viaggi per le altre città?

Va a Scutari, a Valona, ad Argirocastro e a Korcia.

Il viaggio per Korcia lo farò in aeroplano.

E në Shkodër me çfarë mjeti doni me shkue?
Në Shkodër due me shkue me automobil pse më kanë thânë qi udha nuk âsht e gjatë.
Sa km. janë?
Janë gjithsejt 120 km; për katër orë shkohet në Shkodër.
Due me pá urën e Matit e Leshin.
Në Shkodër kemi me shkue bashkë; kam disa punë për të krye.
A ndalemi me pushue pak në këtë kafe? Më ka marrë etja.
Sot po bân shumë të nxetë.
Çka po pijmë?
Po marrim nji shishe birrë.

Mirë.

A Scutari con quale mezzo vuol andare?
A Scutari voglio andare con l'automobile, perchè m'hanno detto che il viaggio non è lungo.
Quanti km. sono?
Sono in tutto 120 km.; in quattro ore si va a Scutari.
Voglio vedere il ponte di Mati ed Alessio.
A Scutari andremo insieme; ho certi affari da sbrigare.

Fermiamoci a riposare un po' in questo caffè? Ho sete.

Oggi fa molto caldo.
Che cosa beviamo?
Prendiamo una bottiglia di birra.
Va bene.

Te nji tregtar cohësh.

Urdhnoni, zotni, çka dishroni?
A keni cohë të mira?
Due me blé do cohë të mirë për nji palë petka.
Këtu kemi gjithfarë cohësh. Çfarë boje e doni?

Da un commerciante di stoffe.

Comandi, signore, che cosa desidera?
Avete buone stoffe?
Voglio comperare della stoffa buona per un vestito.
Qui abbiamo stoffe d'ogni qualità. Di che colore la vuole?

Më qitni ndonji cohë t' a shof, por të jetë e mbylltë.
Qe, kjo âsht fjesht leshi.
E mirë qênka, por tepër e lehtë për dimën
Ka edhe mâ të trasha; âsht nji cohë blu shum' e mirë.
Si Ju duket kjo?

Kjo po më pëlqen, por nuk më duket se âsht krejt leshi.
Ju siguroj, zotni, se âsht e mirë si tjetra, fort e qindrueshme e boja nuk i lot S' kanë mbetë veçse edhe pak metra.
Sa bân? Sa e shitni metrën?

Qênka fort shtrêjt?
Gjâja e mirë kushton. Në daçi po Ju diftoj cohë edhe mâ të lira, por jo ksi soji; janë të dobta. Shoqen e ksaj cohe nuk mund t' a gjêni kund. Kqyreni njikët soj cohet, kushton mâ pak.
Nuk due tjetër veç nje këtê, por keni me m' a dhânë mâ lirë.
Nuk mundemi, çëmimi âsht i premë.
M i preni tri metra
E bajshi me shëndet.
A keni petka gati për fëmijë?

Fatemi vedere qualche stoffa, ma che sia scura.
Ecco, questa è di pura lana.
E' buona, ma troppo leggera per l'inverno.
Ve ne sono anche di più pesanti; c'è una stoffa blu molto buona. Come Le sembra questa?
Questa mi piace, ma non mi sembra tutta di lana.
L'assicuro, signore, che è buona come l'altra, molto resistente e di tinta sicura. Ne sono rimasti pochi metri ancora.
Quanto costa? Quanto la vende il metro?
E' molto cara.
La roba buona costa. Se vuole Le mostro anche stoffe a bassi prezzi, ma non di questa qualità, sono mediocri. Simile stoffa non la può trovare in nessun posto. Guardi questa qualità di stoffa, costa di meno.
Non ne voglio altra, soltanto questa, ma me la darete a minor prezzo.
Non possiamo, il prezzo è fisso.
Tagliatemene tre metri.
Lo possa portare in salute.
Avete abiti pronti per bambini?

Janë disa petka fëmijësh, por me pantalona të shkurtë.
E sa kushtojnë?
Zgjidhni nji palë se po Ju a napim lirë.
Nuk dij masën e djalit, por kam me kthye nesër.
Mirë.

Vi sono alcuni vestiti da bambini, ma con i calzoni corti.
Quanto costano?
Ne scelga uno, chè glielo diamo a buon prezzo.
Non so la misura del ragazzo, ma ritornerò domani.
Va bene.

Te prestari.

Puna e mbarë.
Të mbarë paçi.
Un due me bâ nji petk të ri.
A dishroni me pá mostrat e cohvet? Na kanë ardhë do mostra cohësh të bukura prej Anglije.
Jo, pse cohën e kam blé, por due të më merrni masën.
Si e doni petkun?
Mbas modet të mbrapme.
A e doni setrën mâ të gjatë se këtê?
Po, m' a lëshoni pak mâ të giatë se këtê qi kam veshë.
E pantallonat?
Pantallonat i due pak mâ të shkurtë.
Ç' astar doni me i vû setërs?

Nji astar të mëndafshët.

Dal sarto.

Vi sia prospero il lavoro.
Abbiate prosperità.
Voglio fare un vestito nuovo.
Desiderate vedere i campioni delle stoffe? Ci sono arrivati dei bei campioni di stoffe dall' Inghilterra.
No, perchè la stoffa l'ho comprata, ma voglio che mi prendiate la misura.
Come volete l'abito?
All' ultima moda.
Volete la giacca più lunga di questa?
Sì, lasciatela un po' più lunga di questa che porto addosso.
E i calzoni?
I calzoni li voglio un po' più corti?
Che fodera desiderate mettere alla giacca?
Una fodera di seta.

Për kur e doni petkun ?
Per quando volete l'abito?

Në mbarim të javës qi vjen, në qoftë e mundun.
Per la fine della settimana prossima, se è possibile.

Jam mjaft i xânë me porosina të tjera, por kam me ju a krye në javën tjetër padyshim.
Sono abbastanza occupato con altre ordinazioni, ma glielo farò nell' altra settimana, senza dubbio.

Kam nevojë për tê. Ju lutem me u-kujdesë në të preme qi të më bjerë mirë për shtat.
Ne ho bisogno. Vi prego di porre ogni cura nella confezione affinchè mi vada bene attillato.

Mos kini kujdes, ka me ju rá shumë mirë; keni me mbetë shumë i kënaqun.
Non ne dubitate, vi andrà benissimo; rimarrete molto soddisfatto.

Kur mund të vij për provë ?
Quando posso venire per la prova?

Dukuni të mërkurën pasdreke.
Fatevi vedere mercoledì dopo pranzo.

Edhe astaret e tjera të jenë të mira.
Anche le altre fodere che siano buone.

Mos keni kujdes. Të shtunën ju a mbaroj.
Non dubitate. Sabato glielo finirò.

Për të qepun të petkut nuk bâmë pazar; due qi të m' a punojsh mirë.
Per la confezione dell' abito non abbiam fissato prezzo; voglio che sia ben lavorato.

Nuk kam me ju marrë shumë; keni me pague si gjithë myshterit e tjerë.
Non vi prenderò molto; pagherete come tutti gli altri clienti.

Berati.	**Berat.**
A ke qênë ndonji herë në Berat ?	Sei stato qualche volta a Berat?
Po, kam qênë dý herë për	Sì, vi sono stato due volte per

punë tregtije. Udhën e kam bâ prej Durrsit me automobil, por shkohet në Berat edhe nga Vlona.

E si âsht udha?

Udha âsht e mirë, por duhet me kalue dy lumna: Shkumbînin e Sèmanin. Me automobil bâhet për katër orë.

Nuk qênka fort larg.

Gjithsejt janë 120 km.

A jeni ndalë ndokund për me pushue?

Jemi ndalë pak në Kavajë edhe në Lushnjë.

E si âsht Kavaja?

Kavaja âsht nji qytet i vogël, afër Durrsit, me 7000 banorë. Âsht vênd bujqsuer; ka shumë ullîj e bakti.

Po Lushnja?

Lushnja âsht nênprefekturë me 2500 banorë.

Âsht e përmêndun në historîn e rilindjes kombtare, në këtë qytet âsht mbledhë, me 21 kallênduer 1920, kongresi kombtar i cili, me vêndimet e veta, siguroi indipendencën e Shqipnís.

Ka shumë tokë pjellore, shumë kullota e shumë bakti.

affari commerciali. Il viaggio l'ho fatto da Durazzo con l'automobile, ma si va a Berat anche da Valona.

E com'è la strada?

La strada è buona, ma bisogna attraversare due fiumi: lo Shcumini ed il Semani. Con l'automobile s'impiegano quattro ore.

Non è molto lontano.

In tutto ci sono 120 km.

Vi siete fermati in qualche posto per riposare?

Ci siamo fermati un po' a Kavaja ed a Lushnja.

Com'è Kavaja?

Kavaja è una piccola città vicina a Durrazzo, con 7000 abitanti. E' paese agricolo; ha molti ulivi e bestiame.

E Lushnja?

Lushnja è sottoprefettura con 2500 abitanti.

E' rinomata nella storia del risorgimento nazionale, perchè in questa città si è riunito, il 21 gennaio 1920, il congresso nazionale il quale, con le sue sanzioni, assicurò l'indipendenza dell'Albania.

Ha molti terreni fertili, molti pascoli e molto bestiame.

Në këtë vënd gjindet nji shkollë bujqsije.
Pastaj prej Lushnjes kemi shkue drejt në Berat.
E si t'âsht dukë Berati?
Për së largu qyteti i Beratit ka nji të pamë me të vërtetë të bukur.
Afër Beratit naltohet mali i Tomorrit i lartë 2396 m. Tomorri âsht Olimpi i Shqipnís.
Nëpër qytet kalon Osumi ose lumi i Beratit.
Qyteti a âsht i vjetër?
Berati âsht nji qytet i vjetër. Motit quhej Pulqeriopolis. Pulqerija qe e motra e Theodhosit dhe mbretnesha e Bizancit.
Atëherë do të ketë edhe ndonji monument të vjetër.
Ka nji kalá shumë të moçme e disa kishë bizantine.
Kishët mâ të përmêndunat për vjetërsi e për piktura janë: kisha e Shën Mrís, kisha e Shën Triadhës dhe Kathedralja.
Çë popullsi ka Berati?
Berati ka 10·000 banorë.
Qyteti ka fillue m'u zbukurue me ndërtesa të reja e me rruga.
A âsht vênd i pasun?

In questo paese trovasi una scuola d'agricoltura.
Poi da Lushnja siamo andati direttamente a Berat.
Come ti è sembrato Berat?
Da lontano la città di Berat offre una veduta veramente bella.
Vicino a Berat s'innalza il monte Tomor, alto 2396 m. Tomor è l'Olimpo dell'Albania.
Per la città passa Osum, oppure il fiume di Berat.
La città è antica?
Berat è una città vecchia. Anticamente chiamavasi Pulcheriopoli. Pulcheria fu la sorella di Teodosio e imperatrice di Bisanzio.
Allora avrà anche qualche monumento antico.
Ha una fortezza molto antica e delle chiese bizantine.
Le chiese più rinomate per antichità e per gli affreschi sono: la chiesa di Santa Maria, la chiesa della Santa Trinità e la Cattedrale.
Che popolazione ha Berat?
Berat ha 10.000 abitanti.
La città ha incominciato ad abbellirsi di nuovi edifizi e di strade.
E' un paese ricco?

Krahina e Beratit âsht shum' e pasun në pikpamje të bujqsís e të tregtís. Në këtë prefekturë shtrîhet fusha e Myzeqés, e cila motit qe hambari i Rromakvet.

Çka prodhon mâ tepër ?
Prodhon : grunë, misër, elb, tërshânë, ullîj, bakti : kual, pula, vé, voj.

La regione di Berat è assai ricca dal punto di vista agricolo e pastorizio. In questa prefettura si estende la pianura di Musacchia, la quale anticamente fu il granaio dei Romani.
Che cosa produce di più?
Produce grano, granoturco, orzo, avena, ulive, bestiame, cavalli, galline, uova, olio.

Te këpuctari.

Mirë mëngjes.
Mirë se vijni, zotni. Urdhnoni.
A keni këpucë gati?
I kemi disa parë gati. Çfarë këpucësh dishroni? A i doni të zeza a të verdha?
Unë dishroj nji parë këpucë të zeza, por qi të më bijnë mirë.
Ç numër kanë këpucët?
Kanë numrin 42.
Besoj qi këto kanë me Ju rá mirë. Faqet e shojet i kanë të mira dhe janë të qëndrueshme.
Më bijnë pak të ngushta.
Mos ki frikë, tue i mbathë kanë me lëshue.

Dal calzolaio.

Buon giorno.
Benvenuto, signore. Favorisca.

Avete delle scarpe pronte?
Ne abbiamo alcune paia pronte. Che scarpe desidera? Le vuole nere o gialle?
Io desidero un paio di scarpe nere, ma che mi vadano bene.
Che numero hanno le scarpe?
Hanno il numero 42.
Credo che queste scarpe Le staranno bene. Hanno le tomaie e le suole buone e sono resistenti.
Sono un po' strette.
Non tema, calzandole si allargheranno.

Nuk më bâjnë, drue se më vrasin kâmbët. A keni ndonji parë mâ të gjâna?

Non mi vanno, temo che mi facciano male ai piedi. Avete qualche paio più larghe?

Provoni këto të tjerat. Si Ju bijnë?

Provi queste altre. Come Le vanno?

Këto po më bijnë mirë, por nuk më pëlqen forma; pastaj edhe faqet nuk më duken të mira.

Queste mi vanno bene, ma non mi piace la forma; poi anche le tomaie non mi sembrano buone.

Atëherë mund të Ju bâjmë gati nji parë këpucë të reja mbas qefit t'Uej.

Allora possiamo prepararle un paio di scarpe nuove di Suo gusto.

Por më duhen shpejt.

Però, mi occorrono presto.

Për kur i doni?

Per quando le vuole?

A mund të m'i bâni gati për të shtunën mbrâma?

Potete prepararmele per sabato sera?

Të shtunën mbrâma i keni gati.

Sabato sera le avrà pronte.

Atëherë m'a merrni masën për nji parë këpucë te reja.

Allora prendetemi la misura per un paio di scarpe nuove.

Ju porosis me m'i bâ të gjâna e të përputhuna për kâmbë.

Vi raccomando di farmele larghe e aggiustate al piede.

Çfarë formet i doni?

Che forma desidera?

Kjo formë më pëlqen. Faqet e shojet të jenë të mira.

Questa forma mi piace. Le tomaie e le suola che siano buone.

Mos kini kujdes; puna ka me dalë e bukur dhe e mirë.

Non ne dubiti; il lavoro riuscirà bello e buono.

Të shtunën Ju a çoj në shtëpí.

Sabato gliele manderò a casa.

Shumë mirë.

Benissimo.

Me marrë shtëpí me qirá.

Kush trokllon në derë?
A âsht zoti . . . . në shtëpí?
Po, zotní; si i thonë emnit zotnis s' ate?
Zotnija i yt nuk më njef; thueji se kam ardhë me pá shtëpín qi do me vêndue me qirá.
Urdhnoni mbrêndë.
Mirë mëngjes, zotní.
Më kanë thânë se zotnija e jote ka nji shtëpí për të vêndue me qirá. Sa oda ka shtëpija?
Pesë kthina: nji odë zjarmit (akshihane), nji odë buke, nji odë me pritë e dý oda të tjera; poshtë ka nji qur.
A mund t' a shof?
Urdhnoni.
A âsht larg?
Âsht këtu ngjitë me shtëpí t' eme. Qe, ky âhht quri. Tash po hypim nalt.
Qe oda e miqve.
Qênka pak e errtë; ku bijnë këto dritore?
Bijnë në rrugë. Këto janë dý odat e tjera qi mund të përdoren si oda për me fjetë.

Prendere una casa a pigione.

Chi bussa alla porta?
Il signor . . . . . è in casa?
Sì, signore; come si chiama Lei?
Il tuo padrone non mi conosce; digli che sono venuto per vedere la casa che vuole affittare.
Favorisca entrare.
Buon giorno, signore.
Mi hanno detto che Lei ha una casa da affittare. Quante stanze ha la casa?

Cinque vani: una cucina, una sala da pranzo, un salotto da ricevere ed altre due camere; abbasso c'è una cantina.

Posso vederla?
S'accomodi.
E' lontana?
E' qui vicina alla mia casa. Ecco, questa è la cantina. Adesso saliamo su.
Ecco la stanza da ricevere.
E' un po' scura; dove danno queste finestre?
Danno sulla strada. Queste sono le altre due stanze che si possono usare come camere da letto.

Këto qênkan të mëdhá e paskan mjaft dritë.
Ku shohin dritoret?
Shohin mbi kopësht.
Këtu âsht oda e zjarmit, e ngjitë me tê oda e bukës.
Oda e bukës qênka e vogël; nuk paska vênd për me vû raftin.
Nuk âsht e madhe sa odat e tjera, por ka mjaft vênd midis dý dritorevet për me vû raftin e bukës.
Kopshti me cilën shtëpí bân pjesë?
Shtëpija ka përpara oborrin e mbrapa nji copë kopësht. N'oborr âsht trumba.

Sa qirá kërkoni për këtë shtëpí?
Si shef, qiraja nuk âsht e shtrêjtë?
Shtëpin po e morr, por ka nevojë m'u ndreqë pak e m'u lye.
Për kur e doni gati?
Me nji të mojit qi vjen.
Nesër kam me shtie puntorët; në mbarim të mojit e keni gati.
Mirë.

Queste sono grandi ed hanno luce abbastanza.
Dove guardano le finestre?
Guardano sul giardino.
Questa è la cucina, e vicino ad essa è la sala da pranzo.
La sala da pranzo è piccola; non vi è posto per mettere la credenza.
Non è grande come le altre stanze, ma vi è abbastanza posto fra le due finestre per mettervi la credenza.
Di quale casa fa parte il giardino?
La casa ha davanti il cortile e di dietro un pezzo di giardino. Nel cortile c'è la tromba idraulica.
Che affitto domanda per questa casa?
Come vede l'affitto non è caro.
Prendo la casa, ma ha bisogno di essere un po' riparata ed imbiancata.
Quando la vuole pronta?
Il primo del mese prossimo.
Domani metterò al lavoro gli operai; alla fine del mese l'avrà pronta.
Va bene.

Shkodra.	**Scutari.**
Po i afrohemi Shkodërs.	Ci avviciniamo a Scutari.
Kqyr, mbi at kodër âsht kalaja Rozafat.	Guardi, su quella collina è la fortezza Rosafat.
A âsht e vjetër kjo kalá?	E' antica questa fortezza ?
Kalaja Rozafat âsht shum' e moçme e ka nji gojdhânë të bukur.	La fortezza Rosafat è antichissima ed ha una bella leggenda.
Sí quhet ky lum qi rrjedh afër kalás?	Come si chiama questo fiume che scorre vicino al castello?
Quhet Drinaz; âsht nji bisht i Drinit.	Si chiama Drinas; è un ramo del Drin.
Tash po kalojmë urën e Drinazit a të Baçallekut.	Adesso traversiamo il ponte di Drinasi, oppure di Baciallek.
Si i thonë ksaj kishe?	Come si chiama questa chiesa?
Kjo âsht kisha e Zojës së Shkodërs, ndërtue mbi rrenimet e kishës së vjetër. Kundruell âsht fabrika e alkoholit.	Questa è la chiesa della Madonna di Scutari, costruita sulle rovine della vecchia chiesa. Dirimpetto vi è la fabbrica di alcool.
Po këto ndërtesa çka janë?	E queste costruzioni cosa sono?
Janë dyqanet e tregut.	Sono le botteghe del mercato.
Tregu gjindet dý kilometra larg qytetit.	Il mercato si trova due chilometri distante dalla città.
Tash po hûjmë në qytet.	Ora entriamo in città.
Qyteti qênka mjaft i hapët e mbulue an' e kând me pemë.	La città è abbastanza vasta e adorna dappertutto di alberi.
Shkodra shtrîhet në nji fushë e shtëpit kanë oborre e kopshtije.	Scutari si estende su una pianura e le case hanno cortili e giardini.
Âsht nji qytet i madh; njehë 29.000 banorë.	E' una grande città; conta 29.000 abitanti.

A âsht shum' i vjetër qyteti?
Shkodra ka qênë kryequteti i Ilirve të vjetër.
Në njetin 168 p. K. ra nên sundim të Rromakvet. Këtu konë sundue edhe Venedikasit me 1479 mbas nji rrethimi të gjatë ra në dorë të Tyrqvet.
Po. rrethimin e Shkodërs e kam pá të pikturuem në Venedik, në salën e pallatit Dukal.
Kush e ka bâ at pikturë?
Nji piktor italjan shumë në zâ, Pal Veronese.
A ka vjetërsina qyteti?
Qyteti âsht i vorfën me monumenta historikë. Shtatë kilometra larg qytetit gjindet ura e Mesit, ndërtue prej Venedikasvet.
Kjo ndërtesë qênka e madhe.
Âsht pallati i prefekturës; ndërtesat kundruell jonë kazermat e ushtarvet.
Rrugat i paska të mira e të pastra.
Ka shtëpi të bukura e dý kisha të mëdhá me dý kumbonare të nalta: Kathedralen e kishën e françeskâjvet.
A bân shumë të nxetë në verë?

La città è molto antica?
Scutari è stata la capitale degli antichi Illiri.
Nell'anno 168 av. Cr. cadde sotto il dominio dei Romani. Qui governarono anche i Veneziani; nel 1479, dopo un lungo assedio, cadde nelle mani dei Turchi.
Sì, l'assedio di Scutari l'ho visto dipinto a Venezia, nella sala del Palazzo Ducale.

Chi l'ha fatto quel quadro?
Un pittore italiano molto rinomato, Paolo Veronese.
Ha delle antichità la città?
La città è povera di monumenti storici. Sette chilometri distante dalla città trovasi il ponte di Mesi, costruito dai Veneziani.
Questo edifizio è grande.
E' il palazzo della prefettura; gli edifizi dirimpetto sono le caserme dei soldati.
Le strade sono buone e pulite.

Ha belle case e due grandi chiese con due alti campanili: la Cattedrale e la chiesa dei francescani.

Fa molto caldo in estate?

Në verë bân të nxetë, por klima âsht e mirë dhe uji i ftohtë.
Më bâhet se kemi mbërrijtë.
Po, ky âsht hoteli mâ i mirë. Të zdrypim.
Tash po pushojmë pak e pastaj po dalim me shetitë nëpër qytet.

In estate fa caldo, ma il clima è buono e l' acqua fresca.

Mi pare di esserci arrivati.
Sì, questo è il migliore albergo. Scendiamo.
Ora riposiamo un po' e poi usciremo a passeggiare per la città.

Në treg.

Nodja e mirë. Si keni ndjehë?
Pak lodhshëm prej rrugës.
A keni fjetë mirë?
Kam fjetë shumë mirë; së më ka dalë gjumi asnji herë.
Unë nuk kam mujtë me fjetë prej të nxetit.
A keni pí gjâ?
Kam marrë nji filxhan qumësht.
Atëherë po dalim; sot po shkcjmë në treg të madh.
Karrocjer, ndalu; na ço në pazar.
Prej kah janë këto grá me këto petka të çudiçme?
Janë malsore e katundare.
Vesha e malsivet dhe e katundevet të Shkodërs âsht shumë piktoreske.

Al mercato.

Buon giorno. Come si è alzato?

Un po' stanco dal viaggio.
Ha dormito bene?
Ho dormito molto bene; non mi sono svegliato nemmeno una volta.
Io non ho potuto dormire pel caldo.
Ha bevuto qualche cosa?
Ho preso una tazza di latte.

Allora usciamo; oggi andiamo al grande mercato.
Cocchiere, fermati; portaci al bazar.
Di dove sono queste donne con questi costumi bizzarri?
Sono montagnole e contadine.
Il costume delle montagne e dei villaggi di Scutari è molto pittoresco.

Në këtë ndërtesë do të jetë ndonji fabrikë.

In questo edifizio vi sarà qualche fabbrica.

Po, âsht fabrika e makaronavet.

Sì, vi è la fabbrica della pasta.

A ka fabrika të tjera në qytet?

Vi sono altre fabbriche in città?

Shkodra ka nisë me përparue me industrí: ka mullîj miellit me zjarm, dý fabrika makaronash, dý fabrika të mëdha cingaresh, sapunore, fabrikën e cementës e nji fabrikë të madhe birret.

Scutari ha cominciato a progredire nelle industrie: ha molini di farina a vapore, due pastifici, due grandi fabbriche di sigarette, saponerie, la fabbrica di cemento ed una grande fabbrica di birra.

Sa të bukura qênkan këto dyqane me gjithfarë pemësh!

Quanto sono belle queste botteghe con frutta d'ogni specie!

Në këtë patalok shiten baktit; në nji vênd tjetër vét. djathi, gjalpi, pulat e mâ andej drithët.

In questo piazzale si vende il bestiame; in un altro posto si vendono le uova, il formaggio, il burro, il pollame e più in là i cereali.

Çka shesin ato grá?

Che cosa vendono quelle donne?

Shesin petka kombtare e pëlhura të bukura mëndafshit e pambukut.

Vendono costumi nazionali e bei tessuti di seta e di cotone.

Ky jelek qênka me të vërtetë punue bukur.

Questo corpetto è veramente lavorato bene.

Grát e Shkodërs bâjnë pëlhura të bukura mëndafshit e pambukut dhe dijnë mirë me qindisë.

Le donne di Scutari fanno bei tessuti di seta e di cotone e sanno ricamare bene.

A shkojmë ku shitet peshku?

Andiamo dove si vende il pesce?

Po; më kanë thânë se në Shkodër del shumë peshk.
Gjuhet shumë peshk në Bunë e në liqê.
A âsht i madh liqêni?
Liqêni i Shkodërs (lacus Labeatis) âsht gati 45 km. i gjatë 15 km. i gjânë me nji sypërfaqe 325 km².
Buna del prej liqênit e âsht nji lum i lundrueshëm.
Si quhet mali qi shifet përtej Bunës?
Âsht Taraboshi; poshtë atij mali, në breg të liqênit, âsht katundi i Shirokës. Në Shirokë âsht vila e Mbretit, nji ndërtesë e hijshme me nji panoramë të bukur.
Qe vêndi ku shitet peshku.

Sot paska shumë peshk.
Çfarë peshku âsht ky?
Qefull; eksportohet n'Itali.
Prej qefullit nxiren putargat.
Sa lloje peshqish gjinden në liqê?
Shumë lloje: ngjala, krep, levrekë, shojza, trofta, giuca. Mund te zêhen deri në 60.000 kuintal peshk në vjetë.

Sì; mi hanno detto che a Scutari c'è molto pesce.
Si pesca nella Bojana e nel lago.
E' grande il lago?
Il lago di Scutari (lacus Labeatis) è lungo quasi 45 km. e 14 kl. largo con una superficie di 325 km.².

La Bojana esce dal lago ed è un fiume navigabile.
Come si chiama il monte che si vede al di là della Bojana.
E' il Tarabosh; sotto quel monte, in riva al lago, vi è il villaggio di Scirocca. A Scirocca c'è la villa del Re, un grazioso edifizio con un bel panorama.

Ecco il luogo dove si vende il pesce.
Oggi c'è molto pesce.
Che qualità di pesce è questo?
Cefalo; si esporta in Italia.
Dal cefalo si ricavano le bottarghe.
Quante qualità di pesci si trovano nel lago?
Molte qualità: anguille, carpioni, branzini, sogliole, trote, sardelle. Si possono pescare fino a 60.000 quintali di pesce all'anno.

Gjutija e peshkut âsht nji pasuni për vênd.	La pesca è una ricchezza per il paese.
Çka prodhon tjetër krahina e Shkodërs?	Che produce d'altro la regione di Scutari?
Prodhon duhan të mirë, grunë, kallamboq, sanë, lesh, lëkura, qymyr, shqeme.	Produce buon tabacco, grano, granoturco, fieno, lana, pelli, carbone, sommacco.
Jemi vonë; ka rá 12.	E' già tardi; son suonate le 12.
A shkojmë në qytet a hamë këtu?	Andiamo in città o mangiamo qui?
A ka ndonji restorant të mirë?	Vi è qualche buon ristorante?
Po shkojmë te ura e Bunës; afër âsht nji restorant.	Andiamo verso il ponte della Bojana; lì vicino c'è un ristorante.

Familja.	**La famiglia.**
A dini ku rri me shtëpí Z. . . . . ?	Sa lei dove sta di casa il Signor . . . . . ?
Në rrugën Skanderbeg, por nuk më bije ndër mênd numri.	In via Scanderbeg, ma non ricordo il numero.
A e njifni?	Lo conosce?
E njof mirë; âsht nji burrë i ndershëm e puntuer.	Lo conosco bene; è un uomo onesto e laborioso.
Sa fëmijë ka?	Quanti figli ha?
Pesë: dy djelm e trí goca.	Cinque: due ragazzi e tre fanciulle.
A i ka të mëdhâj djelmt?	Sono grandi i ragazzi?
Mâ i madhi âsht gjashtëmbëdhetë vjeç.	Il più grande ha sedici anni.
E i dyti sa vjeç âsht?	E il secondo quanti anni ha?

I dyti âsht trembëdhetë vjeç; vajzat i ka mâ të vogla.
A i a njef zojën?
Zoja e tij shifet rrallë jashtë; âsht grue shtëpijake.
Print a i ka gjallë?
E âma rron edhe, por âsht plakë tepër; i ati i ka vdekë.
I vëllai a gjindet në Shkodër?
I vëllai nuk âsht këtu.
Ku ka vojtë?
Banon me familje të vet në Tiranë.
A qênka martue?
Po, âsht martue tash dy vjet, por nuk ka fëmijë.
Çka bân në Tiranë?
Ka hapë nji dyqan ku shet gjâna ushqimi. Âsht tue punue mirë.
E i vëllai si shkon këtu me punë?
Në Snkodër ka punë pak
Si po i rriten fëmijët?

Fëmijët po i bâhen shumë të mirë. Janë të zgjuet, shkojnë në shkollë e janë tue nxânë shumë mirë.
Djali i madh edhe dy vjet kryen licén.
Po gzohem.

Il secondo è sui tredici anni; le ragazze sono più piccine.
Conosce la signora?
La sua signora si vede di rado fuori; è donna casalinga.
Sono vivi i genitori?
La madre vive ancora, ma è molto invecchiata; il padre gli è morto.
Suo fratello si trova a Scutari?
Suo fratello non è qui.
Dove è andato?
Abita con la sua famiglia a Tirana.
Si è sposato?
Sì, si è sposato da due anni, ma non ha figli.
Che fa a Tirana?
Ha aperto una bottega dove vende generi alimentari. Sta lavorando bene.
E suo fratello come va qui con gli affari?
A Scutari ci sono pochi affari.
Come gli stanno crescendo i figli?
I figli stanno diventando molto buoni. Sono intelligenti, vanno a scuola e studiano assai bene.
Ancora due anni e il figlio maggiore finisce il liceo.
Mi compiaccio.

Nji vizitë.

Kqyr, kê shof! Si jé?
A je shëndosh e mirë?
Mirë jam me shëndet.
Kur ke ardhë?
Kam ardhë qyshë pardje.
Tash dý dit je këtu e s'ke ardhë me më pá?
Mjáft keq!
Besa kam dashë me ardhë, pormë kanë pengue disa punë.
Sa po gzohem qi po të shof! Ka shumë kohë qi nuk jemi pa.
A do të rrijsh ndonji ditë?
As unë nuk e dij; çka më duket kam me ndêjun nji javë.
Nji javë! shumë mirë; atëherë ke me qênë mik (mysafir) në shtëpí t'eme.
Së due të të bezdisi.
S âsht punë qi bâhet, ndryshe më vjen keq.
Tash po shkojmë në shtëpí.
Ku ke rá? Tash po çoj sherbtorin për me të marrë valigjen.
Zojën e fëmijët si po i ke?
Janë të gjithë shëndosh.
Sot kam emnin e djalit të madh.
E gzoftë për shumë vjet!

Una visita.

Guarda, chi vedo! Come stai?
Stai bene?
Sto bene di salute.
Quando sei venuto?
Sono venuto l'altro ieri.
Da due giorni sei qui e non sei venuto a visitarmi?
Abbastanza male!
In fede mia ho voluto venire, ma me lo hanno impedito certi affari.
Quanto mi rallegro nel rivederti! Da parecchio tempo non ci siamo visti.
Starai qui qualche giorno?
Non lo so neanch'io; mi pare che ci starò una settimana.
Una settimana! benissimo; allora sarai mio ospite a casa.

Non voglio disturbarti.
E' impossibile; altrimenti mi rincresce.
Ora ci avviamo verso casa.
Dove hai preso alloggio? Adesso manderò il servo a prenderti la valigia.
Come stanno la signora e i figli?
Stanno tutti bene.
Oggi è l'onomastico di mio figlio maggiore.
Goda l'onomastico per molti anni!

Kjo âsht shtëpija e eme.
Po të paraqes t' eme shoqe.
Ulu.
Të lutem, kafe nuk due; kam pij shumë kafe sot.
Po pijmë ka nji gotë rakí.

Me nderë t' ânde; për të mirë; mirë se të gjeta.
Të bâftë mirë e mirë se na erdhe.
Kur të jetë buka gati, mund të hamë.
Si të duesh, tryeza âsht shtrue.
Urdhno e ha si në shtëpí t' ânde.
Merr edhe pak peshk; a nuk po t' a kânda?
Peshku qênka shum' i mirë.
Âsht i mirë edhe i freskët; sot në mëngjes ka ardhë krej Pogradecit.
E ku zêhet?
Në liqê t' Ohrit.
Si të duket kjo venë?
Shum' e shijshme.
Pije at gotë se po e mbushim edhe nji herë.
Nuk mundem mâ; kam pí mjâft.
Atëherë po pijmë kafet, po pushojmë pak e pastaj po dalim me shetitë.

Questa è la mia casa.
Ti presento mia moglie.
Siediti.
Ti prego non voglio caffè; ho bevuto oggi molti caffè.
Beveremo un bicchierino d' acquavita.
Al tuo onore; alla tua felicità; ben trovato.
Buon prò ti faccia e ben venuto.
Quando il pranzo sarà pronto, possiamo mangiare.
Come vuoi; la tavola è apparecchiata.
Favorisci, mangia come in casa tua.
Prendi ancora un po' di pesce; non ti piace?
Il pesce è buonissimo.
E' buono ed anche fresco; stamane è venuto da Pogradez.
Dove si pesca?
Nel lago di Ocrida.
Come ti pare questo vino?
E' squisito.
Bevi quel bicchiere perchè lo riempiamo un' altra volta.
Non ne posso più; ho bevuto abbastanza.
Allora prenderemo il caffè; riposeremo un po' e poi uscriremo a passeggio.

Elbasani.	**Elbasan.**
Kah po shkojmë?	Dove andiamo?
Po bâjmë nji shetí kah rruga e Kurçës.	Facciamo una passeggiata verso la strada di Corcia.
A âsht e mirë kjo rrugë?	E' buona questa strada?
Kjo rrugë âsht e mirë dhe e ré. Sot Elbasani ndodhet i lidhun me rruga të mira me Korçë, me Durrës e me Berat.	Questa strada è buona e nuova. Oggidì Elbasan trovasi allacciato per mezzo di buone strade con Corcia, con Durazzo e con Berat.
A âsht larg Korça prej këndej?	Quanto dista Corcia da qui?
Âsht 157 km. larg.	Dista 157 km.
Si âsht vêndi?	Com'è il paese?
Vêndi âsht i hapët e i pasun. Ka shumë bakti: dhên, dhí, qé, lopë, kual e pradhon grunë, misër, duhan, oriz, ullîj e pemë.	Il paese è vasto e ricco. Ha molto bestiame: pecore, capre, buoi, vacche, cavalli e produce grano, granoturco, tabacco, riso, ulive e frutta.
Në treg kam pá shumë pemë. Pemët me të vërtetë ishin të shijshme.	Al mercato ho visto molte frutta. Le frutta erano veramente saporite.
Elbasani âsht qyteti i lulevet e i pemvet. Ka shumë portokala. molla, dardha, arra, kështênja.	Elbassan è la città dei fiori e delle frutta. Possiede molti aranci, meli, peri, noci, castagni.
Edhe ujin e paska të mirë.	Anche l'acqua è buona qui.
Po, uji âsht i lehtë e i ftohtë, por klima nuk âsht aq' e shëndoshë; vêndi âsht malarik.	Sì, l'acqua è leggera e fresca, ma il clima non è tanto sano; il paese è malarico.
Sa banorë ka?	Quanti abitanti ha?
Nuk ka mâ tepër se 12.000 frymë.	Non ha più di 12.000 anime.

Por qyteti përmbrênda nuk qênka aspak i bukur; shtëpit e dyqanet qênkan të vjetra.

A thue âsht i moçëm qyteti?

Elbasani nuk ka monumenta të vjetër historikë. Thohet te âsht ndërtue mbi gërmadhat e qytetit të vjetër **Scampa.**

A ka kalue këtej pari udha e vjetër **Aegnatia?**

Udha e madhe **„Via Aegnatia“,** *qi fillonte prej Durrsit, ka kalue nëpër këto vênd e tue prekë Selanikun ka mbarue në Bizanc.*

Kam ndigjue se afër Elbasanit janë disa kroje surfullit.

Po janë banjat e surfullit të Llixhës, të rralla n' Evropë.

Për çfarë sëmundjesh janë të vjefshme?

Janë të vjefshme sidomos për reumatizëm (jel).

Tash po kthejmë në shtëpi se âsht bâ vonë.

Kemi bâ nji sheti të bukur.

Ma la città interna non è punto bella; le case e le botteghe sono vecchie.

E' forse antica la città?

Elbassan non ha vecchi monumenti storici. Si dice che è stata costruita sulle rovine dell' antica città di Scampa.

Passava di qui l'antica Via Aegnatia?

La grande Via Aegnatia, che incominciava da Durazzo, attraversava questo paese e toccando Salonicco finiva a Bisanzio.

Ho sentito che vicino ad Elbasan vi sono delle sorgenti di acque sulfuree.

Sì, vi sono i bagni sulfurei di Lligia, rari in Europa.

Per quali malattie sono efficaci?

Sono efficaci specialmente per i reumi.

Ora ritorniamo a casa perchè si è fatto tardi.

Abbiamo fatto una bella passeggiata.

Në kopësht.

Sot po do me bâ shumë të nxetë!
Nuk po mund të rrihet në shtëpí!
Në daçi po dalim në kopësht, po bâjmë nji shetí e marrim edhe pak ajr.

Mirë, por tue shetitë në diell kemi me e ndie mâ tepër të nxetët.
Mund të rrijmë nên ndonji pemë të madhe qi të na presë diellin.
Mbasi paska hije po dalim.
Paska bî shumë bar!
Ka rá shumë shí në javën qi shkoi, e bari âsht rritë fort shpejt.
Çfarë lulesh janë ato?
Janë vjollza (manushaqe), e lulet e bardha qi shef janë zambakë.
A ka edhe trândafille?
Mâ andej keni me pá trândafillet. Kam shum lloje trândafillesh e të bukura fort. Kam edhe karajfila, lule Milanit, lule vathë, goj krape, lule shebojë. Lulet m' i kânda fort.
Këto trândafille qênkan me të vërtetë të bukura!

Nel giardino.

Oggi vuol far molto caldo!

Non si può stare in casa!

Se vuole, usciamo nel giardino, facciamo una passeggiata e prendiamo anche un po' d'aria.
Va bene, ma passeggiando al sole sentiremo di più il caldo.
Possiamo stare sotto qualche grande albero che ci ripari dal sole.
Siccome c'è ombra usciamo.
E' spuntata molta erba!
Ha piovuto molto la settimana scorsa, e l'erba è cresciuta rapidamente.
Che fiori sono quelli?
Sono violette, ed i fiori bianchi che vede sono gigli.

Vi sono anche delle rose?
Più in là vedrà i rosai.
Ho molte qualità di rose e bellissime. Ho anche garofani. dalie, fuchsie, bocche di leone, violaciocche. I fiori mi piacciono molto.

Queste rose sono veramente belle!

A mund t'a këpus këtë trândafile?

Posso cogliere questa rosa?

Këputeni. Merrni edhe lule të tjera e bâni nji tubë për me e marrë në shtëpí.

La colga. Prenda altri fiori ancora e ne faccia un mazzo da portare a casa.

Si i thonë ksaj peme?

Come si chiama quest'albero?

Kjo âsht qershí; mâ tutje janë kumbullat, pjeshkat, ftojt e fiqt. Rreth kopshtit kam vû hardhí.

Questo è un ciliegio; più in là vi sono i susini, i peschi, i cotogni ed i fichi. Intorno al giardino ho piantato viti.

Sa në shëndet qênka kjo zerdelí!

Quant'è sano quest'albicocco!

E kam shartue vjet mbi nji kumbull.

L'ho innestato l'anno scorso su un susino.

A doni me pá edhe kopshtin ku kam mbjellë barishet?

Vuol vedere anche l'orto dove ho coltivato gli erbaggi?

Me gjithë qejf.

Volentieri.

Kaloni n'at anë.

Passi da quella parte.

Këtu janë kungujt e trangujt.

Qui vi sono le zucchette ed i cetrioli.

Po shof edhe pjepna e sharqîj.

Vedo anche meloni e cocomeri.

Mollatartat (domatet) kanë nisë m'u kuqë. Paske nji kopësht të bukur!

I pomodori hanno cominciato a diventar rossi. Ha un bel giardino!

Nuk e lâ kurr pa pleh; por marr prej si gjithfarë barishtesh: qepë, hud-a, bize, bishtaja groshe, spinaq, sallata. Tash janë tue u rritë laknat. Kam mbjellë lakna krença e lakënlule.

Non lo lascio mai senza letame; ma ricavo da esso ogni sorta di erbaggi: cipolle, agli, piselli, fagiolini, spinaci, lattughe. Ora stanno crescendo i cavoli. Ho piantato cavoli capucci e cavolfiori.

Në udhtim për Korçë.

Tash qi kemi pá Shkodrën a doni me ardhë me mue në Korçë?
Me giithë qejf. Nuk kam qênë kurr në Korçë e dishroj me e pá.
Kur do të nisemi?
Kemi m'u nisë nesër me ajroplan.
Atëherë sot po zâ dý vênde.
Shumë mirë.
Ku do të shifemi nesër?
Kam me ardhë me ju marrë në shtëpi.
Mbaroni punët sonde qi të jeni nesër gati.
U pjekshim me të mirë!

* * *

A jeni gati? Shpejtoni pse jemi vonë.
Ka kohë; ajroplani nuk niset kaq shpejt.
Mâ mirë m'u gjetë përpara në fushë t'ajroplanavet.
A po e pini nji kafe?
Ju falem nderës, nuk mundem.
Sonde nuk kam fjetë mirë; më ka dalë gjumi heret fort.
Tash jamë gati, mund të shkojmë.

In viaggio per Corcia.

Ora che abbiamo visitato Scutari, vuol venire con me a Corcia?
Con molto piacere. Non sono stato mai a Corcia e desidero visitarla.
Quando partiremo?
Partiremo domani con l'aeroplano.
Allora oggi fisso due posti.
Benissimo.
Dove ci vedremo domani?
Verrò a prenderla a casa.

Termini i lavori stasera per essere pronto domani.
Arrivederci.

* * *

E' pronto? Faccia presto perchè siamo in ritardo.
C'è tempo; l'aeroplano non parte così presto.
Meglio trovarci prima al campo degli aeroplani.
Vuol bere un caffè?
Grazie, non posso.

Stanotte non ho dormito bene; mi sono svegliato molto presto.
Ora sono pronto, possiamo andare.

Çë mot i bukur!
Udhtimi n' ajroplan ka me qênë fort i bukur.
E besoj.
Qe fusha e avjacjonit.
Ajroplani qênka gati për m' u nisë Të hypim shpejt.

* * *

Kemi bâ nji udhtim shumë të bukur.
A ke pasë frigë?
Në fillim kam pasë frigë. por pastaj u-mësova. U dashka pak guxim.
Në të zbritun kam admirue panoramën e bukur të Korçës.
Hamall na merr valigien e na ço në nji hotel të mirë.

Che bel tempo!
Il viaggio in aeroplano sarà molto bello.
Lo credo
Ecco il campo d'aviazione.
L'aeroplano è pronto per la partenza. Saliamo subito.

* * *

Abbiamo fatto una bellissima gita.
Hai avuto paura?
Prima ho avuto paura, ma poi mi sono avvezzato. Ci vuole un po' di coraggio.
Nella discesa ho ammirato il bel panorama di Corcia.

Facchino, prendete la valigia e portateci in un buon albergo.

Korça.

Qyteti i Korçës qênka i bukur dhe shum' i pastër.
Nuk âsht vetëm i bukur, por edhe modern. Këtu jeta shoqnore âsht mjaft e giallë.
Ndonse jemi edhe në verë, mbrâmë kam ndie pak të ftohtë.

Corcia.

La città di Corcia è bella e molto pulita.
Non è soltanto bella, ma anche moderna. Qui la vita sociale è abbastanza attiva.

Quantunque si sia ancora in estate, ierisera ho sentito un po' di freddo.

Korça gjindet 845 m. mbi sipërfaqe të detit.
Në dimën bân shumë të ftohtë e bije shpesh borë.
Atëherë do të jetë vênd i shëndoshtë
Po, vêndi ka klimë e ujë të mirë.
Ç' popullsí ka?
22.700 banorë.
Më kanë thânë se ka rrethe të mira për me verue.
Rrethet janë piktoreske; katundet Drenova, Boboshtica, Hoçishti, Voskopoja e Dardha kanë të pame fort të bukura.
Ku verohet mâ fort?
Shkojnë në Dardhë, në Voskopojë e në Pogradec.
Me çfarë mjeti shkohet?
Me automobil.
Voskopoja ka qênë motit nji qytet i madh.
Ku gjindet Pogradeci?
Pogradeci âsht nji vênd i vogël në buzë të liqênit t' Ohrit. Ka për rreth male shumë madhshtore.
Ky qytet do të jetë edhe i mirë për banja.
Shumë familje shkojnë në verë në Pogradec për me gzue bukurit e natyrshme të vêndit e të liqênit.

Corcia si trova 845 m. sul livello del mare.
Nell' inverno fa molto freddo e nevica spesso.
Allora sarà un paese sano.

Sì, il paese ha buon clima ed acqua buona?
Che popolazione ha?
22.700 abitanti.
Mi hanno detto che ha bei dintorni per passare l'estate.
I dintorni sono pittoreschi: i villaggi di Drenova, Boboshtiza, Ocishti, Voscopoia e Dardha offrono delle belsime vedute.
Dove si passa per lo più l'estate?
Vanno a Dardha, a Voscopoia ed a Pogradez.
Con che mezzo ci si va?
Con l'automobile.
Voscopoia è stata anticamente una grande città.
Dove è situato Pogradez?
Pogradez è un piccolo paese situato sulla riva del lago di Ocrida. Ha intorno monti assai maestosi.
Questa città sarà pure ottima per i bagni.
Molte famiglie vanno in estate a Pogradez per godere le bellezze naturali del luogo e del lago.

A âsht i madh liqêni?
Liqêni i Ohrit (lacus Lychnis) âsht 30 km. i gjatë, 14 km. i gjânë e ka 269 km.² sipërfaqe. Âsht i pasun me peshq.
Çfarë peshku zêhet?
Ka mâ tepër njala e nji lloj trofte qi quhet koran.

Si i thonë ksaj rruge?
Âsht rruga e Shën Gjergjit.
E kjo kishë si quhet?
Kisha e Shën Gjergjit, nji kishë e bukur dhe e pasun me piktura.
Ku po shkojmë tash?
Kah tregu; sot âsht e shtunë, ditë pazari.
Sa të bukur qênkan këta qylyma!
Vêndsit e rrethevet të Korçës i punojnë shumë mirë qylymat, velenxat e shajakun.
A e kanë leshin e mirë?
Krahina âsht e pasun me baktí; prandej prodhon lëkura, lesh e djathë të mirë.
Këtu shitet drithët.
A ka tokë të plleshme?
Ka nji fushë pjellore, por gruni nuk mjafton për nevojë të vêndit.

E' grande il lago?
Il lago di Ocrida (lacus Lychnis) è lungo 30 km., 14 km. largo ed ha 269 km.² di superficie. E' ricco di pesci.
Che pesci vi si pescano?
Contiene molte anguille ed una qualità di trota che si chiama **koran.**
Come si chiama questa via?
E' la via di San Giorgio.
E questa chiesa come si chiama?
Chiesa di San Giorgio, una chiesa bella e ricca di affreschi.
Dove andiamo ora?
Verso il mercato; oggi è sabato, giorno di mercato.
Quanto sono belli questi tappeti!
Gli abitanti dei dintorni di Corcia lavorano assai bene i tappeti, le coperte di lana ed il panno.
E' buona la lana?
La regione è ricca di bestiame; perciò produce pelli, lana, e buon formaggio.

Qui si vendono i cereali.
Ha terreni fertili?
Ha una pianura fertile, ma il grano non basta ai bisogni del paese.

Në këtë rrugë s' po shof tjetër veç kovaçë.

In questa via non vedo altro che fabbri ferrai.

Shumë rruga të tregut janë të zâna vetëm prej nji lloj mjeshtrije: saraçë, këpuctarë, rrobaqepës etj.

Molte vie del mercato sono occupate da una categoria di artigiani: sellai, calzolai, sarti ecc.

Kqyr, ky dyqan paska cohë të mira.

Guarda, questo negozio ha buone stoffe.

Janë cohë inglize. Korça âsht e lidhun me Greqí e sidomos me Selanik me anë t' udhës së hekurt të Fëllërinës.

Sono stoffe inglesi. Corcia è in comunicazione con la Grecia e specialmente con Salonicco per mezzo della ferrovia di Florina.

A punon me Sarandë e me Durrës?

Lavora con Santiquaranta e con Durazzo?

Tregtín e jashtme e bân edhe me anë të limanit të Durrsit e me anë të Sarandës.

Il commercio con l'estero lo fa pure per mezzo del porto di Durazzo e di Santiquaranta.

Jam lodhë; sot kemi ecë tepër.

Sono stanco; oggi abbiamo camminato troppo.

Po kthejmë në hotel; mbrâma tash shkojmë në cinematograf.

Ritorniamo all'albergo; stasera andremo al cinematografo.

Nji të grishun.

A doni me ardhë nesër në katund?

Në qoftë koha e mirë vij me gjithë qejf, por âsht vrâ e drue se nesër ka me rá shí.

Un invito.

Vuol venire domani con me in campagna?

Se sarà bel tempo verrò volentieri, ma il cielo si è rannuvolato e temo che domani pioverà.

Tash âsht verë e koha ndërron menjiherë; nuk besoj se ka me rá shí.
Me çka po shkojmë?
Kâmbë; në daçi po marrim nji karrocë.
A âsht larg ai katund prej këndej?
Âsht dý orë larg.
Më duhet me shkue për me pá vëneshtat.
Si po âsht rrushi sivjet?
Deri tash ka mjaft rrush; hardhivet nuk u ka rá asnji lëngatë.
Në ç'orë do të nisemi?
Po çohemi keret, po e bâjmë udhën për fresk.
Çka po marrim me hângër?

Nuk po bâjmë gjâ gati, po blejmë ndonji kutí sardela e pak përshutë; ndonji send tjetër e gjêjmë në katund.
Ku do të rrijmë?
Në shtëpí të buikut; mund të pushojmë edhe në vëneshtë nên nji tândë të bukur.
Un po marr çiften, zagarin edhe disa fyshekë.

A ka tashti gjah?
Ka mjaft gjah: shkurta, pë-

Ora siamo in estate ed il tempo cambia subito; non credo che pioverà.
Con che mezzo andremo?
A piedi; se vuole prenderemo una carrozza.
E' lontano quel villaggio da qui?
E' due ore lontano.
Debbo andarvi per vedere le vigne.
Com'è l'uva quest'anno?
Fin'ora c'è uva abbastanza; le viti non sono attaccate da nessuna malattia.
A che ora partiremo?
Ci alzeremo presto, faremo la strada col fresco.
Che cosa prenderemo da mangiare?
Non prepariamo nulla, compreremo qualche scatola di sardine ed un po' di prosciutto; qualche altra cosa troveremo in campagna.
Dove ci fermeremo?
In casa dell'agricoltore; potremo riposare anche nella vigna sotto un bel pergolato.

Io prenderò la doppietta, il cane da caccia ed alcune cartucce.
C'è caccia adesso?
C'è abbastanza caccia: qua-

llumba t' egjër, thëllânxa, turtuj, fiksa.
Ku do të shifemi?
Nesër në mëngjes vij me Ju marrë në 5.

glie, colombi, pernici, tortorelle, beccafichi.
Dove ci vedremo?
Domani mattina verrò a prenderla alle 5.

Gjinokastra.

Ksaj here udha na ka lodhë tepër.
Pse? Kur jeni nisë?
Jemi nisë dje nga Korça.
A jeni ndalë në shumë vênde?
Jemi ndalë në Kolonjë, në Leskovik e në Përmet.
Në Përmet kemi fjetë nji natë.
A keni qênë tjetër herë në Gjinokastër?
Jo, kjo âsht e para herë qi po vijmë,
Ç' përshtypje ju ka bâ Gjinokastra?
Për së largu Gjinokastra ka nji të pame shumë piktoreske. por përmbrênda qyteti nuk paska kurrgiâ qi me të tërhjekë.
E pse?
Nuk paska ndërtesa të bukura e rrugët qênkan të ngushta.

Argirocastro.

Questa volta il viaggio ci ha stancati troppo.
Perchè? Quando siete partiti?
Siamo partiti ieri da Corcia.
Vi siete fermati in molti posti?

Ci siamo fermati a Cologna, a Lescovik ed a Permeti.
A Permeti abbiamo dormito una notte.
Siete stati qualche altra volta ad Argirocastro?
No; questa è la prima volta che ci veniamo.
Che impressione vi ha fatto Argirocastro?
Da lontano Argirocastro ha una veduta molto pittoresca, ma, dentro, la città non ha nulla di attraente.

E perchè?
Non ha bei edifizi e le strade sono strette.

Oqtetit i nungon edhe ujët.
A e ka ajrin të mirë?
Prej mungeset t' ujit populli âsht shtërngue të bâjë saranxha e prandej vêndi ka pak malaria.
Sa banorë ka?
Njehë 10.000 frymë e âsht ndêja e nji prefektit.
Në sa nênprefektura dahet?

Ka shtatë nênprefektura të cilat janë: Përmeti, Tepelena, Libohova, Kurveleshi, Delvina, Çamrija e Saranda.
Si âsht gjëndja ekonomike e vêndit?
Disa krahina si Çamrija. Delvina e Kurveleshi kanë shumë baktí: dhên, dhí, lopë, qé. E gjithë prefektura ka 180.000 dhên.

Çka e bajnë qumshtin?
Në prendverë vijnë disa shoqní greke dhe e blejnë për me bâ nji lloj djathi kaçkavall.
E ku e çojnë këtë djathë?

E eksportojnë n' Amerikë.
Çka eksporton tjetër vêndi?
Eksporton lëkura lesh, baktí, sanë, qymyr, peshk, qitra.

Alla città manca pure l'acqua.
L'aria è buona?
Dalla mancanza d'acqua la popolazione è costretta di far delle cisterne e perciò il paese ha un po' di malaria.
Quanti abitanti ha?
Conta 10.000 anime ed è sede di un prefetto.
In quante sottoprefetture si suddivide?
Ha sette sottoprefetture le quali sono: Permeti, Tepeleni, Libohova, Curvelesci, Delvino, Ciameria e Santiquaranta.
Come sono le condizioni economiche del paese?
Alcune regioni come la Ciameria, Delvino e Curvelesci possiedono molto bestiame: pecore, capre, vacche, buoi. Tutta la prefettura ha 180.000 pecore.
Che cosa ne fanno del latte?
In primavera vengono alcune società greche e l'acquistano per farne una qualità di caciocavallo.
Dove portano questo formaggio?
Lo esportano in America.
Che esporta d'altro il paese?
Esporta pelli, lana, bestiame, fieno, carbone, pesci, cedri.

Ku bâhen qitrat?
Rrethet e Delvinës e Himara prodhojnë shumë portokala e qitra.
Cili âsht limani tregtar?
Saranda âsht limani mâ me rândsi i Shqipnís së jugut.

Afër Sarandës janë zbulue disa vjetërsina.
Po, dý orë larg Delvinës, në katundin Finiqi, misjoni arqeologjik italjan ka zbulue rrenimet e akropolit të moçëm të Finiqit. Janë gjetë shtatue, mbishkrime, pare.
Ku shiten gazetat?
Ne këtë udhë, në nji kartoleri afër postës.
Duem të blejmë disa gazeta.
Pasdreke urdhnoni në hotel.

Dove crescono i cedri?
I dintorni di Delvino e Chimara producono molte arance e cedri.
Qual'è il porto commerciale?
Santiquaranta è il porto più importante dell'Albania meridionale.
Vicino a Santiquaranta si sono scoperte delle antichità.
Sì, due ore lontano da Delvino, nel villaggio di Finici, la missione archeologica italiana ha scoperto le rovine dell'antica acropoli di Finici. Si sono trovate delle statue, epigrafi, monete.
Dove si vendono i giornali?
In questa via, nella cartoleria che è accanto alla posta.
Vogliamo comprare dei giornali.
Dopopranzo favorite all'albergo.

Te mjeku.

Si jeni?
Nuk e ndiej veten mirë.
Çka keni? Çka ankoni?
As unë s e dij. Kam shpesh dhimbë kreje; natën nuk bâj giumë të mirë; mbrâmë më kanë zânë ethet.
Si Ju kanë ardhë?

Dal medico.

Come sta?
Non mi sento bene.
Che ha? Di che si lamenta?
Non lo so neanch'io. Spesso ho dolore di testa; di notte non dormo bene; iersera ho avuto la febbre.
Come Le è venuta?

Më kanë ardhë me të përqethuna; pastaj jam ndjersë e bâ ujë. Kam pasë shum' et.

A i keni pasë ethet të tjera herë?

Më kthejnë krye katër ditsh.

Qiteni gjuhën jashtë. Paskeni nevojë m' u syrdisë.

A keni ândë heje?

Më ka tretë krejt ânda; qyshë mbrâmë s' kam shtie gjâ në gojë.

A Ju çohet të pështjellët?

Çka ha e qes jashtë.

Paskeni edhe miden keq.

Sot nuk paskeni ethe.

Jo, tash më kanë lânë, por ethet më kanë dobsue.

Paskeni ethet malarike, por s' âsht gjâ me rrezik.

Po Ju ap nji herë nji bar për m' u syrdisë e disa hapa kine.

Barin keni me e pi nesër e hapat keni me i marrë për disa dit rresht; kështu ethet kanë me kalue.

Ju lumtë goja, doktor, pse kam pasë frikë shumë.

A duhet me mbajtë ndonji perizë?

Nuk âsht nevoja; mund të

Mi è venuta con brividi, poi sono divenuto tutto molle di sudore. Ho avuto molta sete.

Ha avuto altre volte la febbre?

Mi ritorna ogni quattro giorni.

Faccia vedere la lingua. Ha bisogno di purgarsi.

Ha appetito?

Ho perduto completamente l'appetito; da ieri sera non ho assaggiato nulla.

Ha moti di vomito?

Quel che mangio lo butto fuori.

Ha pure lo stomaco guasto.

Oggi non ha febbre.

No; ora mi è cessata, ma la febbre mi ha indebolito.

Ha la febbre malarica, ma non c'è pericolo.

Le prescriverò per ora una medicina per purgarsi e delle pastiglie di chinino.

La medicina la prenderà domani e le pastiglie le prenderà per alcuni giorni di seguito; così la febbre passerà.

Grazie, dottore, perchè ero molto preoccupato.

Occorre stare a qualche dieta?

Non c'è bisogno; potrà man-

hani çdo send qi të Ju ketë ânda e qi âsht për ushqim e fuqi të trupit.
Në verë keni nevojë me ndërrue klimë; me shkue më ndonji vênd të shëndoshë, sidomos në bjeshkë ase në breg të detit për me bâ banja.
Mbas tri a katër ditsh kam me ardhë prap me Ju pá.

giare ogni cosa che le piace e che serve per nutrire e rinvigorire il corpo.
In estate avrà bisogno di cambiare clima, di recarsi in qualche paese salubre, specialmente sulle alpi, oppure in riva al mare per fare i bagni.
Dopo tre o quattro giorni ritornerò di nuovo per visitarla.

Koha.

Si âsht koha?
Koha âsh e keqe; deri në mjesditë ka qênë e bukur, tash ka nisë me frŷ nji erë e fortë.
Çfarë ere âsht tue frŷ?
Âsht tue frŷ juga.
A âsht vrâ qiella?
Qiella âsht mbushë me rê.
Larg veton e bumbullon; nuk ka me ngjatë e ka me rá shí, ka me andhë nji shí i madh.
A bije spesh shí?
Këtu bije spesh shí, sidomos në vjeshtë.
A ndien pak të ftohtë?
Sot âsht tue bâ edhe të ftohtë: duket se âsht tue rá borë malevet.

Il tempo.

Com'è il tempo?
Il tempo è brutto; fino a mezzogiorno è stato bellissimo, adesso ha cominciato a tirare un vento forte.
Che vento sta tirando?
Sta soffiando lo scirocco.
Si è rannuvolato il cielo?
Il cielo si è coperto di nuvole.
In lontananza lampeggia e tuona; non tarderà molto e pioverà; verrà una pioggia dirotta.
Piove spesso?
Qui piove spesso, specialmente in autunno.
Sente un po' di freddo?
Oggi sta facendo anche freddo: sembra che stia nevicando sulle montagne.

Jemi në vjeshtë e ajri âsht freskue.
A bije borë në dimën?
Këtu në dimën bije rrallë borë, por bân shumë të ftohtë. Shtëpít kanë shumë lagshtinë.
Si i keni odat e shtëpís?
Oda ku flêj âsht e ngrohtë, por të tjerat janë të ftohta.
A ndizni zjarm ndër oda?
N' odë të bukës ndezi sobën, ndër odat e tjera mbaj tangarë.
Tash po kthej në shtëpí, pse drue mos të më zânë shiu. Çë ditë e keqe!

A doni umbrelën t' eme?
Nuk âsht nevoja; po shkoj me vrap para se të fillojë me rá shí.
Âsht tue cikrrue pak, Ju kshilloj me e marrë umbrelën qi të mos lageni.
Mirë, po e marr; tash Ju a çoj me sherbtoren.
Lâmtumirë e faleminderës.

Siamo in autunno e l'aria si è rinfrescata.
Nevica nell' inverno?
Qui nell' inverno nevica raramente, ma fa molto freddo. Le case sono molto umide.

Come ha le stanze della casa?
La camera da letto è calda, ma le altre sono fredde.
Accende fuoco nelle stanze?
Nella sala da pranzo accendo la stufa, nelle altre stanze tengo i bracieri.
Adesso ritorno a casa, perchè temo che non mi colga la pioggia. Che brutta giornata!
Vuole il mio ombrello?
Non c'è bisogno; vado di corsa prima che incominci a piovere.
Sta piovigginando, la consiglio di prendere l'ombrello perchè non si bagni.
Va bene, lo prendo; glielo manderò con la serva.
Addio e grazie.

Vlona.	**Valona.**
Mirë se ardhët.	Ben venuto.
Mirë se Ju gjeta.	Ben trovato.
Kur keni mbërrijtë?	Quando siete arrivati?

Kam ardhë mbrâmë nga Gjinokastra.

A do të rrini hëtu ndonji ditë?

Do të rrij dý a trí dit e pastaj do të nisem për Itali.

A keni bâ ndonji sheti nëpër qytet?

Kam shetitë pak. Qyteti paska rruga të drejta e të giâna, shtëpi të kândëshme e dyqane të bukura.

Ndër këto vjetët e mbrapme âsht zbukurue mjaft. Pak jashtë qytetit gjindet nji spital i madh.

A âsht i vjetër qyteti?

Qyteti i Vlonës nuk âsht fort i vjetër, por âsht i përmêndun në histori të rilindjes kombtare. Në këtë qytet u shpall me 28 nânduer 1912 indipendenca e Shqipnís.

Sa banorë ka?

Ka 7.000 frymë, por âsht vênd malarik. Në verë bân shumë të nxetë.

Tash më duhet me shkue në sqele, a doni me ardhë?

A âsht larg limani?

Dý kilometra, po marrim nji karrocë. Kam me

Sono venuto ieri sera da Argirocastro.

Starete qui qualche giorno?

Mi fermerò due o tre giorni e poi partirò per l'Italia.

Avete fatto qualche passeggiata per la città?

Ho passeggiato un po'. La città ha strade diritte e larghe, case graziose e bei negozi.

In questi due ultimi anni si è abbellita abbastanza. Un po' fuori del paese trovasi un grande ospedale.

E' vecchia la città?

La città di Valona non è molto antica, ma è rinomata nella storia del risorgimento nazionale. In questa città si è proclamata il 28 novembre 1912 l'indipendenza dell'Albania.

Quanti abitanti ha?

Ha 7.000 anime, ma è paese malarico. In estate fa molto caldo.

Adesso debbo andare allo scalo; volete venire?

E' distante il porto?

Due chilometri; prendiamo una carrozza. Ho da ritirare un

nxjerrë nji bangë nga dogana.
Mirë, po vij edhe unë.
Karrocjer, na çoni në sqele.

Si i thonë atij qyteti të vogël qi shifet mbi at kodër?
Âsht Kanina, nji qytet i vjetër.
A ka ndonji monument të moçëm?
Ka nji kalá të madhe, ndërtue prej venedikasvet.
Çë kodra të bukura ka Vlona! Të gjitha janë të veshuna me ullîj
Ullîjt janë pasunija e ksaj krahine. Vêndi âsht i pasun edhe me vëneshta e me bakti.
Çka eksporton mâ tepër?
Eksporton ullîj, voj, bakti, lesh, lëkura, djathë.
Kjo âsht sqelja.
Çë liman i bukur!
Limani i Vlonës âsht shum' i hapët e nji ndër limanet mâ të bukura t' Adriatikut.
Nga vjen kjo serë?

Sera nxiret në Selenicë prej nji shoqnije italiane.
A âsht larg ky katund?

pacco dalla dogana.

Va bene, vengo anch' io.
Cocchiere, conduceteci allo scalo.
Come si chiama quella piccola città che si vede su quella collina?
E' Canina, una città antica.

Ha qualche vecchio monumento?
Ha una grande fortezza, costruita dai veneziani.
Che belle colline ha Valona! Tutte sono rivestite di ulivi.

Gli ulivi sono la ricchezza di questa regione. Il paese è anche ricco di vigne e di bestiame.
Che cosa esporta di più?
Esporta ulive, olio, bestiame, lana, pelli, formaggio.
Questo è lo scalo.
Che bel porto!
Il porto di Valona è molto ampio, e uno dei più bei porti dell' Adriatico.

Da dove viene questo bitume?
Il bitume si estrae a Seleniza da una Società italiana.
Dista molto questo villaggio?

Gjindet 16 km. larg; mund të shkohet edhe me udhë të hekurt.

Trovasi 16 km. lontano; si può andarvi anche col treno.

A ka të tjera mademe kjo krahinë?

Possiede altre miniere questa regione?

Në Penkovë, në Selenicë e ngjeti janë tue u-bâ kërkime për voj gurit.

A Pencova, a Seleniza ed altrove si stanno facendo ricerche per il petrolio.

Afër sqeles gjinden krypporet e Vlonës.

Vicino allo scalo si trovano le saline di Valona.

A po më pritni pak në këtë kafe? Po shkoj në doganë për me nxjerrë bangën e po vij shpejt.

Mi aspettate un po' in questo caffè? Vado alla dogana per ritirare il pacco e torno subito.

Nuk po ndalem në kafe; po ju pres në breg të detit.

Non mi fermo al caffè; vi aspetto lungo il mare.

N'agjencí t'avullorevet.

Nell'agenzia dei piroscafi.

A ka sonde avullore qi niset për Brindisi?

C'è stasera piroscafo che parte per Brindisi?

Sonde nuk ka avullore për Brindisi.

Stasera non c'è piroscafo per Brindisi.

Po avullorja qi gjindet në limân ku shkon?

Dove va il piroscafo che trovasi al porto?

Ajo avullore shkon në Durrës e prej Durrsit vijon udhën për Trieshtë.

Quel piroscafo va a Durazzo e da Durazzo continua il viaggio per Trieste.

Të prenden mbrâma ka avullore qi niset për Brindisi.

Venerdì sera c'è un piroscafo che parte per Brindisi.

Prej kah ka ardhë kjo avullore?

Donde è venuto questo piroscafo?

Ka ardhë prej Sarandet.

È venuto da Santiquaranta.

A mund të gjêj avullore në Durrës qi niset për Bari?

Nesër mbrâma niset nji vaporr për Bari.

Në ç'orë niset avullorja për Bari.

N'orën 7.

Kur niset vaporri për Durrës?

Niset sondë n'orën 10.

E kur mbërrîn?

Mbërrîn në Durrës nesër në mëngjes; atje ke kohë me ndêjun gjithë ditën.

Më jepni atëherë nji biletë për të dytën klasë.

A dishroni shtrat për me fjetë?

Dishroj me pague shtratin edhe hén.

Shtratin do t'a pagueni bashkë me biletë; hén keni me e porositë n'avullore.

Kur duhet me hŷ n'avullore?

Âsht mirë me hŷ heret.

A ka shumë mall me shkarkue?

Mallin e ka shkarkue, por tash âsht tue ngarkue lesh e lëkura për Trieshtë.

A ka sonde shum'udhtarë?

Posso trovare qualche piroscafo a Durazzo che parta per Bari?

Domani sera parte un piroscafo per Bari.

A che ora parte il piroscafo per Bari?

Alle ore 7.

Quando parte il piroscafo per Durazzo?

Parte stasera alle ore 10.

E quando arriva?

Arriva a Durazzo domani mattina; là avrà tempo di fermarsi tutta la giornata.

Mi dia allora un biglietto di seconda classe.

Desidera il letto per dormire?

Desidero pagare il letto ed il vitto.

Il letto lo pagherà assieme al biglietto; il vitto l'ordinerà nel piroscafo.

Quando bisogna imbarcarsi?

E' meglio imbarcarsi presto.

Ha molta merce da scaricare?

La merce l'ha scaricata, ma ora sta caricando lana e pelli per Trieste.

Vi sono stasera molti passeggieri?

Sonde janë shum' udhtarë, por disa kanë marrë biletat për të tretën klasë.	Stasera vi sono molti passeggieri, ma alcuni hanno preso i biglietti di terza classe.

Modi di salutare.

Mirë mëngjes! / *Nadja e mirë!*	Buon giorno!
Mirë mbrâma! / *Mbrâmja e mirë!*	Buona sera!
Mirë se vjen!	Benvenuto!
Puna e mbarë!	Vi sia prospero il lavoro!
Të mbarë paç!	Abbi prosperità!
Ndesha e mirë!	Buon incontro!
Kuvêndi i mirë!	Buona conversazione!
Mirë se rijni!	Ben seduti!
Ju lumtë krahi!	Vi sia glorioso il braccio!
Lum qofsh!	Sii glorioso!
Tungjatjeta!	Che ti si prolunghi la vita! (*Si usa in tutte le occasioni*)
Mirë se të gjêj!	Bentrovato!
Mirë se vjen!	Benvenuto!
Mirë se të bije Zoti!	»
Mirë se të ka prû Zoti!	»
Mirë se ardhët!	»
Të bâftë mirë!	Buon pro' ti faccia! (Buon appetito!)
Të mirë paç!	Abbi felicità!
Për të mirë!	Alla vostra felicità!
Me nderë t' uej!	Al vostro onore!
Qofsh me nderë!	Sii con onore!

T' u rrittë ndera!	Che ti cresca l'onore!
Ju falem nderës!	Vi ringrazio!
Ju falem!	Vi saluto!
Udha e mbarë!	Buon viaggio! Buon cammino!
Të qoftë rruga e mbarë!	Buon viaggio!
U pjekshim me të mirë!	A ben rivederci!
Tu mirë vofsh!	Buon viaggio!
Natën e mirë!	Buona notte!
Të mirë e bâfsh!	Buona la faccia!
Lâmtumirë!	Addio!
Të ndiefsha zânin e mirë!	Che possa avere buone nuove di te!
E gzofsh emnin për shumë mot!	Godi il nome per molto tempo (Buon onomastico)!
Ju uroj jetë të gjatë e fatbardhë.	Vi auguro vita lunga e felice.
Ju uroj shëndet e gjithë të mirat!	Vi auguro salute ed ogni bene.
Urime të përzêmërta!	Auguri cordiali!
Faleminderës fort e fort!	Tante grazie!
Faleminderës me gjithë zêmër!	Grazie di tutto cuore!
Qofsh faqebardhë!	Sii con onore!
T' ardhët pleqnija e bardhë!	Abbi vecchiaia felice!
Të lumtë goja!	Grazie (ti sia onorata la parola)!

Frasi vive.

E ka fort në kujdes at punë.	Egli ha molta cura di quell'affare.
Më ka marrë malli për tij.	Ho molto desiderio di vederti!
Çka u bâ, u bâ.	Cosa fatta capo ha.

Nuk jam nji méndjet me tý.	Non condivido la tua opinione.
Bâjmë edhe pa tê.	Possiamo fare a meno di lui,
Mësallë me dý faqe.	Uomo a due facce. Uomo finto.
Më ka marrë ûja.	Ho fame.
Më ka tretë gjumi.	Ho perduto il sonno.
S' ka gjâ.	Non importa.
Mir' e ka.	Gli sta bene.
Tek e ke.	Eccolo qua.
